

GAZMEND KONGOLI

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8.14-32  
K 89.



**AUTO  
KRI  
TI  
KË**

TREGIME  
HUMORISTIKE

BSH-32

K89

GAZMEND KONGOLI

# AUTOKRITIKE

*Tregime humoristike*



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktor: PERIKLI JORGONI

Kopertina nga: SAFO MARKO

## NJOLLAT

Po marr guximin të bëj një autokritikë të sinqertë, sepse e para e punës edhe unë si të gjithë të tjerët dua të hidhem në sulm frontal kundër njollave të shoqërisë së vjetër dhe po filloj nga vetja ime; e dyta, edhe sikur të kisha dëshirë t'i ruaja e t'i zmadhoja këto njolla, të tjerët nuk të lënë kursesi pa ta nxjerrë bojën.

Isha shef i zyrës së strehimit dhe vazhdoja institutin pedagogjik me korrespondencë. Isha në vitin e fundit. Njeriu, sado i pjekur e me eksperiencë të jetë, kur i shtrohet shkollës, merr psikologjinë e nxënësit, kërkon si e si t'u shpëtojë lëndëve më të vështira, i duket e ëmbël kopja e të tjera. Në fakt, edhe kjo psikologji është një njollë e trashëguar nga e kaluara.

Ndër lutjet e qytetarëve që kisha në zyrë ishte edhe ajo e pedagogut Astrit Dule. Fërkova duart. Fërkova mjekrën. I rashë gjoksit. U gëzova. E dija me siguri matematike se pedagogu im i dashur duhej të ishte vërtet në kushte të vështira, në një dhomë të vogël, burrë e grua e dy kalamaj, ashtu

siç shkruante në lutje. Komisioni verifikoi dhe raportoi se Astrit Dulja ishte në gjendje strehimi siç përshkruhej, pa asnjë shtesë zmadhimi në lutjen e tij. U gëzova tejsëtejmes. Unë mund t'i vija vizë menjëherë provimit më të vështirë dhe ta ktheja më sy. Diplomën e kisha në xhep!

Në prak të provimeve, pa humbur kohë, në një zarf mbylla një pusullë zyrtare dhe ja drejtova pedagogut tim të dashur. I shkruaja të paraqitej pranë zyrës së strehimit.

Që të nesërmen pedagogu im i dashur erdhi e u paraqit me vrap në zyrën time. Kisha pregatitur që më parë ligjëratën e bukur e të ëmbël të zyrtarëve që duan singërisht t'i qajnë hallin popullit e t'ja plotësojnë nevojat si duhet.

E prita si mund të presë shefi i strehimit nevojtarin për strehim dhe studenti pedagogun e vet... Dhe, sigurisht, me zgjuarësi, i dhashë të kuptojë se isha unë e vetëm unë ai që mund të bënte çmos për ta sistemuar sa më parë në një apartament komod... Dhe, megjithëse ai kishte plotësisht të drejtë të strehohej sa më parë, unë, edhe sikur të ndodhte që ai të mbetej jashtë listës së parë, i thashë se do ta përmbysja komitetin ekzekutiv, do të bëja të pabërën që ai të futej në listën e parë.

Mbeti shumë, shumë i kënaqur. Më shtrëngoi dorën me përzemërsi dhe u largua gjithë gëzim. Njeriu duhet të jetë artist në zanatin e tij... Dhe i vura vizë pregatitjes e shkova fishek në provimin e shtetit, ku kryesori në komision ishte pedagogu im i dashur, Astrit Dulja. Dhe, o çudi e çudirave, që s'ishte parë e dëgjuar ndonjëherë, ashtu si hyra fishek, ashtu më nxori për dere fishek!

— Nuk e kuptoj se si mund të vihet në provim pa patur gati-gati as idenë e lëndës...

«Të bëj unë që ta kuptosh, o kungull pa fara!» shfryva rrugës, i mbytur në djersë të ftohta.

Diploma më kishte lënë shëndetin për atë vit.

Që ai nuk do të strehohej kurrë derisa të isha unë shef strehimi, kjo s'donte mend. Por nuk ngopesha me kaq. I dërgova një copë pusulle që të paraqitej në zyrën e strehimit.

Që të nesërmen, me vrap, pedagogu i urryer erdhi e më trokiti në derë para gjithë të tjerëve që pritnin radhën të hynin.

E lashë si qen pas derës derisa mbarova pritjen e popullit. Hyri i fundit fare. Gjithmonë buzëqeshur e dashamirës. Më zgjati dorën. Bëra sikur s'e pashë dhe kokulur i thashë:

— Uluni!

U ul gjithë gëzim. Me siguri mendonte se do të merrte autorizimin kur më shikonte që ngatërroja e shkatërroja me duar shkresat në tavolinë e nëpër sirtare. Por unë u çova në këmbë dhe shkova te dera në mënyrë demonstrative. Ai po më ndiqte me sy. Unë rregullova çelësin në bravë, e rrotullova, e mbylla derën, e mora çelësin e ja afrova para hundës:

— E shikon? — i thashë. — Jemi vetëm për vetëm. Unë e ti. Askush tjetër.

Ai e thithi buzëqeshjen e po më vështronte i habitur.

— Kjo domethënë — i thashë unë — që, pasi të dalësh prej këndeje, mund të shkosh ku të duash të ankohesh. Unë mohoj. Ti poho sa të duash. Unë mohoj. Askush nuk ka dëgjuar. Dëshmitarë s'ka. Qartë?

Ai hapi krahët e tha:

— Nuk po kuptoj asgjë!

Ja prita me gjithë dufin që më vlonte për-  
brenda:

— Ende nuk po kuptoni? Sa të jem unë këtu, shoku pedagog, në këtë zyrë ti ta bësh dhëmbin kaq, një pash, këmbës t'i biesh, nuk merr shtëpi! Qartë? Dil e ankohu po deshe e thuaj se kështu e kështu më tha shefi i strehimit. Askush nuk do të të besojë. Shko tani me gjithë qëndrimin tënd parimor në provim!

Kështu ja bëra. Ai doli nga dera i hutuar. S'bë-  
ri as gëk as mëk.

Prita e prita kundërsulmin e tij. Po nuk ndo-  
dhi gjë.

M'u kthye mendja për punë të provimeve. Ven-  
dosa e i hyra derrçe. Mendova se para komisionit  
s'do t'i pinte ujë fjala po të përgatitesha shumë  
mirë, megjithëse ai ishte kryesori. Kisha qejf të  
kaloja në arësim e duhej marrë ajo e shkretë diplo-  
më (edhe kjo një njollë tjetër! Por thashë që në  
fillim po bëj autokritikë të sinqertë për çdo gjë!)

Kur u paraqita para komisionit, për dreq shkon  
e më bie një tezë që më bëri ta humbisja toruan  
fare. Për habinë time të madhe, pikërisht ai u ngrit  
të më orientonte!

Dhe unë kalova. Mora diplomën. Atij i dhanë  
shtëpi. Ju dha e drejta e tij. Listës që ja kisha dër-  
guar për firmë kryesisë në komitet atë ditë që do të  
hyja në provimin e fundit, ata atje lart i kishin  
shtuar edhe emrin e Astrit Dules.

Kjo ngjarje ka disa vjet që ka ndodhur. Unë tani jam koleg me ish-pedagogun tim. Hyra në arësim. Jap matematikë.

Por desha t'ju tregoja anën tjetër të medaljes. Kisha një nxënës shumë të dobët në mësim. Ai ishte i biri i mishshitësit në blokun ku banoja unë. Për të mos u zgjatur po tregoj kulmin:

Në radhë ishin gra e burra. Varur në çengelë, veç copave të tjera ishte edhe një kofshë dashi me gjithë bishtin, që të bënte të të shkonte lëng prej goje. I luteshin disa gra t'u priste nga ajo kofshë. I luteshin edhe ca burra, por mishshitësi nuk jepej, sepse më shikonte mua në radhë.

— S'ka ardhur koha e saj! — përgjegjej ai me skufje të bardhë në kokë.

Kur më erdhi radha mua, i erdhi radha edhe kofshës me bisht.

— A më të lumtë! — më përgëzuan të tjerët që ishin pas meje e që ndoshta shpresonin se mund t'u binte atyre ajo kofshë e dhjamur.

Por tregimi nuk mbaron me kaq.

Djali i mishshitësit e mori maturën. Mirëpo me ta marrë ai maturën, mua, jo vetëm që s'më binte më kofsha me bisht në radhën time, por shpesh s'më binin në dhëmbë as brinjët.

Përsëri tregimi i njollave nuk mbaron me kaq, por autokritika ime besoj se qe aqë e ashpër sa ndoshta atyre, që i kanë këto njolla, do t'u duket çudi si mund të bëhet një autokritikë e tillë për çështje kaq intime...



## HISTORIA E KANDIDATES

— Mos qeshni, jo! Sot fëmijët lindin vërtetë me tetëvjeçare!

Ky muhabet u hap midis xha Myrtos dhe miqve të tij. Miqtë kishin ardhur për urim te xha Myrtua. Vajza e vogël e tij, Agimja, ishte propozuar kandidate për në këshillin popullor të rrethit.

Ashtu erdhi fjala e kuvendi dhe vëllai i madh i xha Myrtos, Sherifi, midis odës plot me miq kërcëu në këmbë me damarin e ballit të ngrehur e i tha të vëllait:

— E po mjaft, de, ja ngrite petët lakrorit, o Myrto, se fundja miqtë kanë ardhur për urim, jo që të qeshin me ne.

Shkopin në dorë, fryu përjashta xha Sherifi dhe shkoi në dhomën tjetër.

Miqtë mbetën keq. Xha Myrtua ja mori me gaz:

— Kështu e ka kjo punë, — u tha xha Myrtua miqve, — më keq se Sherifi isha dhe unë, por ja që i thirrëm mendjes. Që thoni ju...

Fëmija e parë i lindi vajzë xha Myrtos. Dhe,

si i thoshin fjalës, atëhere nxinë edhe trarët e shtëpisë nga kjo e keqe, që e gjeti Myrton. Vajzës i vunë emrin e gjyshes së Myrtos, Mahmude. Që të zbardheshin trarët e shtëpisë, Myrtua mori masat brenda vitit dhe e shoqja, me barkun te buza, dridhej nga frika, se mos nxinte edhe muret e shtëpisë.

U nxinë e u katranosën!

Ndërhyri Sherifi atëhere e i tha:

— Vëlla, vërja emrin Mjaftore kësaj së dytës, se, siç e ka zënë kjo barkzeza gruaja jote, të mori lumi!

Pas një viti lindën dy njëherësh. U steros shtëpia e Myrtos nga Soseja e Përfundimja.

Pikë e vrer Myrtua vendosi, o të dilte djali në mejdan, o njëqind të bëheshin derisa të përmbysej fare shtëpia, që po mbetej pa shtyllë. Kështu lindën me radhë edhe Pushimja e Mbarimja.

Në barrën e gjashtë, kur e shoqja po përgatiste fëmijën e shtatë, Myrtos i qeshi nuri. Ajo shejtanja, mamia e maternitetit të fshatit, i kishte thënë së shoqes së Myrtos se kësaj radhe e kishte me kaull djalë.

E hëngri turpin me bukë Myrtua dhe shkoi e e zuri vetë atë shejtane maminë.

— Me kaull Myrto! — ju betua ajo.

— Shiko se... — i tundi gishtin tregues me kërcënim përpara majës së hundës Myrtua asaj.

— Me kaull! — gajasej ajo shejtanja. — Bile, shpejto, gjej emrin, — i tha ajo — dhe shko e regjistroje që tani sa pa lindur, po deshe!

Dhe Myrtua gjeti emrin. Agim. E shoqja, në maternitet, Myrtua po çalltiste ta digjte me një dar-

kë që ta mbante mend fshati. Lajmi nga materniteti erdhi për vajzë. Po Myrtua qeshte e përgjegjëj:

— Ehe, talluni, ju, talluni. E kam me kaul djalin unë.

Edhe certifikata e maternitetit shkruante vajzë, por Myrtua në këshillin popullor ngulte këmbë se ishte djalë, veç ka bërë shaka ajo shejtanja e maternitetit, që s'di vetëm të qeshë.

— Atë e di unë, — ngulte e nuk shkulte Myrtua — regjistrojeni Agim ju, atë bëni!

E regjistruan Agime ata të këshillit dhe Myrtua mbeti i kënaqur, pasi s'i dinte mirë rregullat e ortografisë.

— Ja, kështu, — u thoshte miqve xha Myrtua — kjo çupa e fundit ma hodhi që kur lindi. Me tetë vjeçare të mbaruar, ore, për nder! Që thoni ju...

Vazhdoi Myrtua, o djalin, o qindin. Por ç'e do, e shoqja nuk lindi më.

Deshte të merrte një grua tjetër, por ju ngri-tën çupat në këmbë e ja bënë tetë me dy. (Shtatë ato dhe e shoqja tetë. Një ai dhe Sherifi dy!)

Se mos ishin çupa sido-kudo çupat e Myrtos? E madhja përgjegjëse e gruas në kooperativë. E dyta agronome. E treta me të katërtën brigadiere. E pesta infermiere. E gjashta studente në Universitet. E shtata, Agimja, sekretare e rinisë së kooperativës.

— Lindi me tetëvjeçare shejtanja. Që thoni ju...

Në krye të rinisë së kooperativës u ngrit e u vuri kazmën kishave e xhamive.

Një ditë prej ditësh e bënë komandante të brigadës dhe me një bylyk vajza e djem çanë e ikën në hekurudhë. Hajt e të dëgjoje Sherifin me

shokë! Ishin ndërkyer se Agimja u mori çupat e i bashkoi me djemtë në aksion...

Kur, doni ju, atje në hekurudhë, ajo na mbledh të gjitha vajzat e fejuara sipas zakonit dhe i vë në rrjesht mënjanë. Mbledh edhe të fejuarit e tyre e i vë në rrjesht përballë. E u thotë çupave: «Kush nuk e do të fejuarin që i kanë dhënë me zor të mykurit, le të flasë këtu haptazi!» e më të plasi kryengritja e çupave, ore...

Hë-hë dhe një ditë na bie në shtëpi një Pandi Pandi, që kishte ardhur agronom në kooperativë.

— Kemi gjashtë muaj që dashurohemi — i thotë Myrtos ajo. — Nëna e di. Me të gjitha motrat e burrat e tyre e kam njohur dhe e kanë pëlqyer. Tani thuaj fjalën tënde edhe ti, baba. Unë me Pandin dua të fejohem.

— Mua — u tha Myrtua miqve — më ra kulmi i shtëpisë e m'u përshesh mbi kokë. E kisha pa një shtyllë shtëpinë. S'kisha me kë të ndaja turpin e hidhërimin. E që thoni ju, vajta te Sherifi.

— Kaurin? — bërtiti Sherifi.

— Kaurin — kishte përsëritur Myrtua.

E bëri lanet Myrtua. S'e pranoi më në shtëpi të bijën. Ata u fejuan e u martuan. Çekanët e çupave të tjera e të burrave të tyre rrihnin pa pushim mbi kokën e Myrtos, por Myrtos i jepte gajret Sherifi e ndonjë tjetër.

«Prit, kur të ndahen, thoshin, se ajo s'është femër, po është lugat...»

Mirëpo ata nuk u ndanë. U trashëguan. U lindi një djalë. Dhe Myrtua mbahej zemërthyer pas Sherifit e ndonjë tjetri. Dhe Sherifi e ndonjë tjetër hapën fjalë se lugati kishte lindur lugat. Djali që kishte lindur ishte pa nishane!

— Kam tre muaj që e theva këmbën e shejtanit, — u tha xha Myrtua miqve — dhe shkova në shtëpinë e sime bije të shikoja me sytë e mi nishanet e nipçes. I kishte të gjitha në vend!

Dhoma plot me miq shpërtheu nga të qeshurat.

U hap dera e hyri Agimja me një tabaka të madhe me pije e me llokume. Miqtë gajaseshin me duar në ije.

— Ç'është kështu, baba? — pyeti Agimja buzagaz, që e dinte se i ati kujtdo që vinte për urime, i tregonte po këtë histori.

— Autokritikë, bija e babait, autokritikë.

Hyri edhe xha Sherifi.

— O po ky na nxori bojën fare, o të shkretën — ju ankua ai miqve.

## ZINXHIRI I MIQVE TË KOOPERUAR

Kësaj të enjte mora letër nga im vëlla.

«I dashur Xhemal,

Jam në hall të madh. Dua të më sigurosh sa më shpejt një *xhunto kardanike*, se e kam punën pisk. Jam informuar se ka me siguri SMT-ja atje. Më duhet të nxjerr nga balta ndërmarrjen. Gjej mënyrën se si t'ua zhvatësh.

Pres me padurim.

Yt vëlla, Xheladini.»

Të gjej mënyrën? Një fjalë goje! Por puna s'pritka. Im vëlla qenka në hall të madh... Pastrova tavolinën e zyrës dhe i futa të gjitha nëpër sirtare e dollape. Zbrita për t'u nisur drejt e në SMT. Kisha ca muhabet me shefin e llogarisë. Përpara kafe «Tomorrit» po hapja sytë për ndonjë mjet me të cilin të mund të shkoja andej. Po, kur do të ecë puna mbarë, ecën. Shefi i llogarisë po drejtohej të pinte një kafe.

— I dashuri, i shtrenjti Xhelil! Ty po të kërkoja. Tani sa po nisesha për te ti në SMT.

Edhe shefi u tregua i përzemërt.

U ulëm në tavolinë dhe porositëm kafet. Fillova larg e larg.

— Do të drejtohesha te ti, i dashur Xhelil, se jam i sigurtë që ti nuk do të ma prishësh. Për miqësinë që kemi.

— Është e qartë, shoku Xhemal, — ma preu ligjëratën shefi — ç'të kem unë në dorë, me gjithë qejf.

— Ja, si e kam hallin, — i thashë — për ty mund të jetë gjë e vogël, hiçgjë mund të jetë, por mua më bën një nder të madh, aqë të madh sa...

— Po ta kem unë në dorë, me gjithë qejf — përsëriti shefi.

— E po, edhe me drejtorin tënd, ti mund të merresh vesh, se unë s'i kam pipëzat mirë me të.

— Nejsë. Ku e keni hallin? — s'i durohej shefit.

— Që ta marrësh vesh ti, hallin s'e kam unë, por im vëlla. Im vëlla është drejtor i ndërmarrjes së artikujve të përzier në qytetin Ç.

— Po — tha shefi.

— E. Më shkruan në letër se i ka ngecur ndërmarrja në baltë dhe, për ta nxjerrë nga balta, i duhet një... një... vegël a pjesë këmbimi, se si e kishte një emër të zorshëm. Një minutë, të shoh letrën.

Dhe nisa të kërkoja letrën nëpër xhepat unë. Ndërsa shefi tha:

Varet se ç'është ajo vegël apo... Por çfarëdo që të jetë...

— E keni, e keni ju. Me siguri e keni. Janë informuar mirë ata — i thashë dhe po bëhesha nervoz që s'po gjeja letrën.

Shefi tha:

— Çfarëdo që të jetë, me siguri drejtori ynë s'e jep pa shkëmbim.

— O po e rregullojmë kollaj atë, po ku dreqin e futa letrën.

I ktheva xhepat mbarë e mbrapsht, po letrën s'e gjeta.

— Një minutë, — i them shefit — nga shpejtësia do ta kem lënë në zyrë. Më prit këtu, se erdha.

— S'ka gjë, — tha shefi — ma thua në telefon, se tani kam një punë urgjente. Ndërkaq po bisedoj edhe me drejtorin dhe, kur të më thuash se çfarë vegle ju duhet, të them edhe unë se ç'kërkon drejtori si shkëmbim.

U ndamë. Unë mora vrapin për në zyrë.

I përmbysa sirtaret e dollapët, i shpartallova dosjet, u bëra ujë në djersë dhe letrën s'e gjeta. I thirra pastrueses, që kishte fshirë kur zbrita unë. Kontrollova plehrat e të gjitha zyrave që kishte grumbulluar pastruesja. Asgjë. Ishte tretur letra e dreqit.

Po humbisja kohën kot së koti. T'i bëja vëllait telegram të më çonte emrin e veglës? Telefon? Posa. Kur m'u kujtua porosia e kryeinxhinjerit tonë për disa materiale që kisha çarë dheun e s'i gjeja. Rast i mirë. Im vëlla ka shumë miq. Me siguri do të më bëjë hall të m'i gjejë. I thashë kryeinxhinjerit. Qe dakord. Treni i dytë nisej për njëzet minuta. U nisa me të katra. E zura trenin.

Me të zbritur, e lashë frymën drejt e në ndërmarrjen e tim vëllai, Xheladinit.

— I dashuri, i shtrenjti vëlla! Puna jote po rregullohet për bukuri, por kemi edhe ne në ndërmarrjen tonë një hall si ti. Na duhen. . .



— More folë, e prure? — kërceu ai nga karrigja.

— Jo. E rregullova, por më duhet emri i asaj veglës, se e harrova.

— Po unë ta shkrova në letër, more. Hajt, mos bëj shaka tani, se më vjen mendja vërdallë, pa atë hallin tënd ta rregulloj në minutë unë!

— Më humbi pra dreqi, më humbi letra. Çava dheun e s'e gjej që s'e gjej.

Im vëlla shtangu. Tha:

— Me gjithë mend e ke, o Xhemal? Por halli, që as unë s'e di se ç'është ajo vegël e s'ja mbaj mend emrin. Ai shefi i planit të NKRSH-së, Xhaferri, e kërkon si shkëmbim, për të më dhënë një ton hekur. Mua më duhet pa derman hekuri, se përndryshe u fika.

— E si të bëjmë?

— Ja, ta marrim në telefon — tha im vëlla.

E mori në telefon Xhaferrin.

— Xhaferr, jam unë, Xheladini... Mirë faleminderit... Ore, si e ka emrin ajo vegla që kërkon ju?... E po më humbi dreqi, s'di nga e lashë... Si? As ti s'e mban mend?... Aaa! E si i bëhet hallit?...

Im vëlla vazhdoi edhe ca muhabetin me atë Xhaferrin. Si mbaroi, uli dorezën e telefonit e tha:

— Është bërë puna lësh. Të nisemi një minutë e më parë.

— Ja tek e ke telefonin — i thashë tim vëllai.

— S'pi ujë telefoni më, o Xhemal. Do operativitet kjo punë. Më digjet toka nën këmbë. Po nuk futa në dorë atë ton hekuri, e mori lumi planin.

I hipëm gazit dhe u nisëm. Për ku, thoni ju? Në veri. Xhaferri s'e kërkonte për ndërmarrjen e

TITIT? ...  
AET...

vet atë veglën. E donte t'ja dërgonte si shkëmbim për disa materiale një fabrike në qytetin për ku u nisëm ne. Pusullën me emrin e veglës Xhaferri e kishte grisur posa kishte rënë në ujdi në pazarllëk me tim vëlla. Dhe i tha në telefon se i vinte mendja vërdallë e s'kishte kohë të merrej përsëri nga e para me marrëveshjen për atë veglën, që as ai s'ja mbante mend emrin.

Gazi fluturonte e dredhonte midis fushave e kodrave.

Im vëlla në ankth për të aritur sa më shpejt rrinte e rrinte dhe herë psherëtinte, herë thoshte ndonjë fjalë.

— Në tërë këtë mesele — tha — më shumë se të gjithë, duket, unë kam lakun në fyt.

— Mos e prish gjakun — i thashë.

— Po s'e nxora unë nga situata, kush do ta nxjerrë ndërmarrjen time! — shpërtheu im vëlla. Vajte e na i bëre punët lëmsh ti me atë dreq letre që humbe dhe tani ma dredh muhabetin.

— S'besoj se i ngatërroi letra — thashë. — I ngatërroi planifikimi. Kaq ndërmarrje e fabrika s'rollaten për një dreq vegle.

— Ehe, — tha im vëlla — dreq vegle, por ajo dreq vegle shpëton nga halli të gjitha ato duar nëpër të cilat do të kalojë.

Arritëm. Ndaluan drejt e në derë të fabrikës. Na priti drejtori, shoku Xhepe. Mirëpo s'ishte thënë të mbaronte atje vrapi ynë. Prej andej shkuam në një ndërmarrje, te shoku Xhoxhi. Pastaj në fabrikën e shokut Xhip. Më në fund mezi arritëm në burim. Vegla i duhej oficinës së SMT-së. Gjetëm shokun Xhemë, që na tha emrin e pjesës së këmbi-

mit. E shkruam në blok qartë e bukur. *Xhunto kardanike*.

Me 90 kilometra në orë morëm tatëpjetë nga veriu në jugë.

Shefi i llogarisë së SMT-së, i dashuri e i shtrenjti miku im, Xhelil Tota, kishte biseduar me drejtorin dhe nuk ishte bërë merak për vonesën e telefonatës sime. Ai na priti me një buzëqeshje të përzemërt. Dëgjoi se ç'kërkonim dhe tha:

— Duket u trembët, ë? Drejtori ynë është shumë i arësyeshëm. Si shkëmbim kërkojmë llamarinë.

— Jepua ti, Xhemal, llamarinën! — m'u drejtua mua në kulmin e gëzimit im vëlla. — Por mundësisht atë xhunton kardanike e duam që tani. Besoj se keni besim, — i tha shefit im vëlla — po të doni, Xhemali ju lëshon edhe dokument.

— Ooo! Më vjen shumë keq! — tha shefi. — Ç'janë këto fjalë. Urdhëroni e merreni që tani. Veç mos na vononi llamarinën — më tha mua.

Im vëlla, Xheladini, i dërgoi xhunton shefit të planit të NKRSH-së Xhaferr Petës dhe i mori tonin e hekurit. Xhaferr Peta i nisi xhunton Xhepe Setës në veri dhe po me atë maqinë mori materialet për të cilat kishte bërë pazar. Xhepe Seta i çoi xhunton Xhoxhi Rrjetës dhe si këmbim mori pjesët e këmbimit që kishin rënë në ujdi. Xhoxhi Rrjeta i dërgoi xhunton Xhip Petës dhe mori pajisjet që i duheshin. Dhe Xhip Peta i dorëzoi xhunton Xhemë Bletës dhe tërhoqi alburokambion që i nevojitej.

— Po unë që mbeta me gisht në gojë? — i them tim vëllai.

— Ua dërgove llamarinën atyre të SMT-së? — pyeti ai.

— Pse, lejon drejtori e kryeinxhinjeri të nxjerr llamarinë unë, pa gjetur ato që të thashë?

Prit t'i mbaj shënim, se do të çalltis unë — tha im vëlla.

Dhe kështu nisi vrapimi tjetër për të gjetur mik pas miku e shkëmbim pas shkëmbimi materialet që i duheshin ndërmarrjes sime.

## QAJNË ARAT PËR NJË BURRË

Kryetari i kooperativës, Kozi, një; llogaritari, Tili, dy; dhe brigadieri, Kici, tre po përgatiteshin për mbledhjen me shumë rëndësi, ku do të shtronin problemin e ngritjes së gruas në përgjegjësi.

— O Tili, o Kici, na gjeti belaja!

— Na gjeti, vërtet, kryetar.

— T'i japim një thelë asaj dreqit, Leftës, që t'ua mbyllim gojën e të mos na nxjerrin telashe më të mëdha. Si thoni ju?

— Mirë thua, o kryetar, po ç'thelë ti japim? — pyeti Kici brigadieri.

— Tënden, o Kici, — tha kryetari — për nja dy-tre muaj, se pastaj ja ndreqim përsëri samarin.

— Ajo është e zonja edhe për llogari — tha Kici.

— Ajo është e zonja edhe për kryetare — tha Tili.

— E po prandaj them ta vëmë brigadiere — tha kryetari — që për dy-tre muaj t'ja rregullojmë samarin se, po e vumë llogaritare, apo, ruajna zot, kryetare, atëhere kush do të mbetet që t'ja ndreqë samarin?

— Mirë thua, o kryetar — tha Tili, llogaritari.  
— Domethënë të ha unë! — tha Kici, brigadieri.  
— O Kici, — tha kryetari — pse bëhesh tuaf?

Kur të kemi lënë në baltë ne ty?

Heshtje.

— E, si thoni? — pyeti kryetari.

— Ashtu të bëhet — tha Tili, llogaritari.

— Ashtu qoftë! — tha Kici i dëshpëruar.

Në mbledhje para kooperativistëve kryetari mbajti një fjalim të shkëlqyer për gratë. Llogaritari mbajti një fjalim të ndritshëm për gratë. Edhe Kici, brigadieri, mbajti një fjalim të ngrohtë për gratë. Dhe menjëherë u kalua në masa konkrete. Kryetari propozoi shoqen Lefta të ngrihej në përgjegjësinë e brigadies, në vend të Kicit.

Që të nesërmen që shoqja Lefta u ngrit në përgjegjësi në kryesi u dhanë raporte se punët nuk shkonin hiç mirë në arat e brigadës që drejtonte shoqja Lefta.

Që javën e parë burrat e brigadës së shoqes Lefta u sëmurën apo u doli punë në klub të kooperativës apo në qytet.

Në krye të muajit u hapën fjalë se shoqja Lefta po dridhte bishtin me djemtë e burrat e botës.

Pas dy muajve, kryetari, i revoltuar nga raportet e zeza, mori mundimin vetë dhe doli të kontrollonte në bazë punën e dobët të brigadës që drejtonte shoqja Lefta. Me vështrimin e tij të vajtueshëm, të tretur fushave, kryetari i shpalli solemnisht suitës së tij:

— Shikoni, more shokë, shikoni, qajnë arat e shkreta për një burrë!

Fjala mori dhenë. Qanin arat për një burrë.

Muajin e tretë gjithshka u bë gati për ta kthyer me ceremoni Kicin në postin e tij. Por se si u ngatërruan punët, se si u përlesh çdo gjë nëpër duar të kryetarit dhe, në mbledhjen e asamblesë, populli foli, ashtu siç di të flasë, troç e drejt.

Në vendin e brigadieres Lefta u vendos shoqja Gjena; në vendin e llogaritarit Tili u vendos shoqja Lefta.

Dhe në krye të muajit nisi përsëri avazi i Mukës: qanin arrat për një burrë dhe shoqja Gjena po dridhte bishtin me djemtë e burrat e botës. Qante dhe llogaria për një burrë dhe shoqja Lefta po i vinte kazmën ekonomisë së kooperativës.

Kësaj radhe kaluan gjashtë muaj për të përgatitur me ceremoni kthimin e Tilit në llogari dhe kthimin e Kicit në postin e tij. Por përsëri se si u ngatërruan punët e se si u përsheshën nëpër duar planet e kryetarit dhe populli foli përsëri troç e drejt.

Në vendin e kryetarit u zgjodh shoqja Lefta, në vendin e llogaritarit u vu shoqja Gjena, në vendin e brigadieres Gjena u vu shoqja Kristina...

Dhe arat e prenë vajtimin. Nuk qanin më për burra, pasi midis tyre punonin si diva ish-kryetari, ish-llogaritari, ishte brigadieri: Kozi, Tili, Kici e të tjerë.

## SARAJI

Zyra e tij është nga veriu. Ai ka njëzet e dy vjet që punon atje, dimër-verë në atë zyrë nuk hyn rreze dielli. Dhe duket gjithmonë e ftohtë, e zyrtë. Ai vetë është shëndetlig. Dimër-verë mër-dhin dhe gjithnjë fërkon duart. Por edhe ngjyra e verdhë e mureve reflekton në fytyrën e tij dhe ai duket sikur e ka kronike sëmundjen e verdhëzës. Ndoshta edhe hekurosja dhe llustrimi pak i tepruar e lëpijnë dhe e bëjnë aq transparent.

Xhanan njeri, i zoti e me një barrë eksperiencë ky Ibrahim Ibrahimi. E duan dhe e respektojnë të gjithë në dikaster. Për rregull s'ja kalon kush. I përpiktë sa s'ja gjen shokun. S'mbahet mend që të ketë gabuar sado pak në detyrën e tij. Dhe detyrën e tij zor se mund ta kryejë ndokush tjetër. Çdo situatë di t'i adaptohet me metoda të reja.

Shkurt është vaksinuar kundër qarkullimit. Askush, as ai vetë nuk mund ta çojë nëpër mend se do të jetë e nevojshme që mos një herë, një herë tjetër të plekset edhe ai me baltën.

Se nga do t'i vijë e se kush do të vërë dorë



dhe do të propozojë shokun Ibrahim Ibrahimi të zbresë poshtë për përforsim të bazës, nuk dihet. Veç dihet që i tërë dikasteri do të ngrihet në këmbë dhe do të kundërshtojë:

— Jo, Ibrahim Ibrahimini nuk e lëmë!

— Propozoni e kërkonti këdo tjetër, vetëm atë jo.

— Jo, e pamundur, pa të nuk bën dot dikasteri...

Kështu është vërtet. Kushdo mund të lëvizë, vetëm Ibrahim Ibrahimi jo.

Por, po të të dalë një herë emri, qoftë për të mirë, qoftë për të keq, të kujtojnë gjithmonë.

Dhe pas dy vjetësh do ta kujtojnë përsëri Ibrahim Ibrahimini. Do t'ja vënë me të madhe që ai të shkulet nga ajo zyrë, ku ka zënë rrënjë që prej njëzet e katër vjetësh.

Të gjithë në dikaster do të ngrihen përsëri në këmbë e do të ngulin këmbë:

— Specialist si ai ne s'kemi ku gjejmë. Ai di tërë historinë e profilit. Ai është specializuar njëzet e katër vjet rrjesht. Ne kemi plot arsye për të mos e lënë të na largohet Ibrahim Ibrahimi.

Ashtu është vërtet. Dhe nuk do ta lënë.

Por radhën e tretë kërkesa do të jetë aq parimore dhe aq e fortë, sa i gjithë dikasteri s'do të ketë shteg tjetër nga t'ja mbajë dhe do të përgjegen si të bindur:

— Jemi dakord, por jo tani, më vonë.

Dhe kështu do të mbetet Ibrahim Ibrahimi në listën e qarkullimit, por, sa herë që do të dalë kjo listë në qarkullim, Ibrahim Ibrahimi do të mbetet gjithmonë për më vonë.

Ndërkaq ai do të teret e do të mpaket me zemër të ngrirë e me mendje të ngritur. Pikërisht në këtë kohë ai do të bëjë gabimin e tij të parë në detyrë. Për një çast nuk do të dijë t'i përshtatet situatës së re me metoda të reja dhe do të veprojë në bazë të psikologjisë së zyrës, të letrave e të studimeve me të cilat i ka mbushur sirtaret e dollapët ding. Se çfarë do t'i kërkojnë nga baza për një aksion me goditje të përqëndruar të paparashikuar. Ibrahim do të gjendet bosh. Do të kundërshtojë:

— Kjo nuk është parashikuar në plan.

Do t'i thonë ata të ndërmarrjes së bazës:

— Kjo do të bëhet se s'bën. Janë ngritur masat në këmbë.

Ibrahimi do ta katranosë më keq:

— Në fund të vitit shohim e bëjmë. Të shohim realizimet, pastaj ta studiojmë ç'sasi...

Të gjithë do të habiten me Ibrahim Ibrahimin. Ai kurrë nuk do të kishte qenë treguar kaq haptazi burokrat. Dhe kur, pas kësaj ngjarjeje do të vijë e para kërkesë për qarkullimin e Ibrahimit, ata të dikasterit nuk do të mundin më të lozin lodrën «Shtyj, ta shtyjme». Dhe Ibrahim Ibrahim do të qendra do të zbresë më së fundi në bazë.

Që ditën e parë do të mbetet pak si keq. Sa do ta nisë punën e re pikërisht në atë ndërmarrje, së cilës i qe bërë pengesë për aksionin. Në zyrën ku do të punojë, do t'i vrasë dielli sytë, do t'i rrahë shiu shpatullat, do t'i zhyten këmbët në baltë, se do ta vënë, sipas profilit që kishte atje lart në dikaster, furnitor. Furnitorin e atjeshëm, njeri që i kishte marrë gjak nëpër vetulla praktikës e teorisë që prej dhjetë vjetësh në bazë, do ta qarkullojnë

dhe do ta çojnë në dikasterin e qendrës, në zyrën e Ibrahimit, në vend të Ibrahimit. Ibrahimit atje në bazë s'do të mund të vërë rregull menjëherë në punë. Do të nisin ta kritikojnë deri për mungesë përpikmërie atë, që në dikaster s'ja gjeje shokun për të përpiktë! Kësaj situatë të re në fillim nuk do të mund t'i adaptohet, jo për gjë tjetër, por ambienti krejt i ndryshëm nga ai i zyrës së tij të ftohtë në dikaster, do të influencojë mjaft te Ibrahimit, do t'i duket sikur punon nën një saç të madh të nxehtë. Të mos e zgjasim. Ai, Ibrahimit, që dikur, dimër-verë, mërdhihte e fërkonte vazhdimisht duart, tani do t'i rrjedhin djersët çurg nën atë saç të skuqur që dimër-verë do ta kalitë.

Së pari do të nisë t'i zhduket ajo ngjyrë e verdhë nga fytyra. Do t'i skuqen faqet Ibrahimit nën valën e saçit të madh. Do t'i ikë verdhëza kronike e do të bëhet buçko. Ndoshta nga e keqja, do të bëjë si ai i motit, dhe do t'i thërrasë nevojës e shpejt e shpejt do të bëhet usta në atë punën e furnitorit. Do të bëhet aq i shkathët e aq i zoti, sa edhe vaj e uthull do të nisë të nxjerrë nga gurët. Por, duke nxjerrë vaj e uthull, do të rrihet edhe ai vetë me vaj e uthull. Dhe kur njeriu rrihet kështu, i fiton gjithë të mirat, në daç hovin, në daç frymën, në daç kërkesat, në daç shpirtin. Të gjitha. Nuk do të pengohet më kurrë.

Një ditë do të thërrasë drejtori:

— Shoku Ibrahim, si t'ja bëjmë hallit?

Ibrahimit do ta dëgjojë me vëmendje drejtorin deri në fund. Ndërmarrja do të jetë vërtet në hall të madh. I vendosur do të thotë:

— Do të shkoj drejt e në qendër, shoku drejtor!

Drejtori do të tundë kokën me mosbesim. Se do të jetë djegur ndonjëherë nga dikasteri në qendër. Në këtë çast të dyve do t'u kujtohet incidenti i aksionit, kur këta të ndërmarrjes ngulnin këmbë të fillonin aksionin pa derman, ndërsa Ibrahim Ibrahimimi, kur ishte atje në dikaster pat kundërshtuar, se aksioni nuk kishte qenë parashikuar në plan.

Do të shikohen sy ndër sy. Ibrahimimi nuk do t'i rezistojë dot vështrimit të drejtorit. Do të ulë kokën e do të thotë:

— Do të provoj, shoku drejtor.

Në dikaster në të dyja dyert që do të trokasë do ta kthejnë duarbosh. Ashtu si Ibrahimimi dikur në qendër, edhe ata nuk do t'i kenë parashikuar në plan kërkesat e Ibrahimimit në bazë. I dëshpëruar do të zbresë shkallët. Por, posa të dalë te portieri, do të dëgjojë ta thërrasin:

— Shoku Ibrahim!

Ku do ta ketë parë këtë fytyrë si të njohur?

— Nuk po më njihni? — do të pyesë tjetri.

Si jo! Si nuk do ta njihite Ibrahimimi. Ai do të jetë dora vetë shemri që i ka zënë zyrën atje në dikaster.

— Si i keni punët? Ç'halle keni? — do ta pyesë e do të interesohet ish-njeriu i bazës që do të ketë zënë vendin e Ibrahimimit në dikaster.

— Këtu e këtu, — do t'i thotë Ibrahimimi — por, ja, më kthyen duarbosh. Tani sa po zbres nga...

Si është e mundur? — do të habitet ish-njeriu i bazës. — Ju keni shumë të drejtë dhe patjetër duhet t'ju japim, bile dyfishin nga sa kërkoni...

Ibrahimimi do të thotë:

— A keni mundësi të ndërhyjni vetëm për kaq sa ju kërkojmë?

— Patjetër, patjetër! Dhe bile dyfishin. Ejani me mua! Do të bëj çmos që t'jua plotësojnë kërkesat.

Dhe ai do t'i futë krahun Ibrahimit dhe do ta ngjitet përsëri lart. Pikërisht në ish-zyrën e ftohtë e të zymtë, ku Ibrahim i pat punuar njëzet e katër vjet, do të mbarojë punë për bukuri. Çudi, sa e ngrohtë do t'i duket Ibrahimit ajo zyrë në ato çaste!

Kur do të dalin jashtë për të pirë nga një kafe, Ibrahim i gëzuar do t'i shtrëngojë dorën shokut. Dhe nuk do të përmbahet pa i thënë:

— Shiko, mos u mburr! Ti vërtet po e kryen punën time këtu në dikaster shumë më mirë se unë, por ama edhe unë punën tënde atje në bazë po e kryej më mirë se ti!

## THËNGJIJTË E MBULUAR

Mahiri u kollit fort posa hyri në oborr të shtëpisë së vëllait, daj Rrapushit. Pastaj thirri:

— Aty je, o Rrapush?

Tjetri ja priti menjëherë, i gëzuar:

— Hajde, mirë se erdhe, Mahir.

Dhe doli e priti në shkallë. U tokën dhe u përshëndoshën dhe hynë brenda.

Daj Rrapushi tha:

— Kam dy ditë që po të pres. M'u bënë sytë ujë. Ti hiç!

— Pse, edhe ti paske ndonjë hall si unë? Të kanë dhembur gjë veshët përsëri?

— Jo, ore, jo. Blemë radio, o ti, Mahir!

Mahiri u mundua të gëzohej:

— Hajt, me hair e me këmbë të mbarë! E gëzofshi. . .

— Po ti, ç'hall paske? — pyeti daj Rrapushi.

Mahiri tundi kokën i vrerosur.

— Lëre mos e nga, — tha — na polli keq me atë nusen e Kamberit, që e bëftë zoti lanet, e bëftë!

Daj Rrapushi u ngrys.

— Pa hë? Ç'është zëri?

— Ka lojtur nga mendtë e kokës. Është çmendur fare. Na ka vënë flakën në shtëpi.

— Si, ore, si? Po paska qenë thëngjill i mbuluar ajo! Të thashë që sefte, o Mahir, t'ua shtrëngoje frerin asaj e Kamberit bashkë. Oj, pesë ditë nuse e re ajo dhe e latë të dilte në punë, në mes të arave!

— O po e harruam atë, po dëgjo të vësh duart në kokë...

— Po hënde, të shkretën, folë, ç'ka bërë vaki, se s'po më mban vendi.

— Kërkon të shkojë në shkollë të natës, o Rrapush vëllai, që e bëftë zoti lëmsh, e bëftë!

— Luaj, ore, vendit... Je në vete?

— Unë po, por asaj i kanë fluturuar mendtë e kokës, po të them!

— Edhe ti dëgjon e bën sehir, ë? Po hazreti dajakun nuk e ke tundur një herë?

Mahiri i ra kokës me grushta dhe u ankua:

— Nuk kam tim bir për të qenë, unë, o Rrapush. Ç'të bëj unë i varfëri. Ajo lanete nuse i ka futur trutë e gomarit Kamberit. Pale, atë kacabunin e vogël, Faslliun, e ka tërbuar fare dhe ma ka vënë këmba-këmbës të më hajë shpirtin që ta lëmë nusen të shkojë në shkollë të natës. Mbrëmë më tha, po s'e lejova, do të më vërë në rrufenë e vatrës së kulturës.

— Kush, ore, nusja kështu?

— Im bir, im bir i vogli, Faslliu! Më është qepur, o Rrapush, që ta vdes në dru, s'më vjen hiç keq. Për zotin, jo, ore!

— E ç'merresh me kalamanin edhe ti. Kambe-

rin, ore, Kamberin bëj zap dhe ai të bëjë zap të shoqen. Burrë i thotë vetes ai?

— Kështu ka ardhur koha, baba — më thotë pa pikë turpi ai.

Me mezetë e rakinë përpara, të dy vëllezërit kokë më kokë, afër mesit të natës i dhanë karar, që të luanin gurin e fundit.

Mahiri të nesërmen e mori veç nusen e të birit, për t'i thënë nja dy fjalë.

— Nuse, — i tha — më ishe dukur e urtë dhe e butë, sypërdhe e kokukur, po paske qenë thëngjill i mbuluar dhe na vure flakën në shtëpi.

— Pse, baba? — foli e drojtur nusja dhe u drodh nga ai kërcënim i egër i të vjehrrit.

— Dëgjo këtu edhe mbylle! Dhe mendohu mirë. Unë i kam marrë parasysh të gjitha. Jo po nuk bëre si po të them, ta dish se s'të zënë 24 orët! Më ka ngelë aq burrëri sa të ta shtyp kokën ty edhe të dy çunave të mi bile. Këtu në shtëpinë time do të bëhet si them unë! Ose në mos, zhdukuni të gjithë! Dhe haram bukën, mallëkim! More vesht?

Mahiri ishte nxehur aqë tepër, sa po i merrej goja dhe harroi t'i thoshte nuses se ku e kishte hallin. Megjithëse nusja e dinte se pse shpërtheu ky kërcënim, pyeti me gjysmë zëri:

— Po për çfarë, o baba?

— S'ka shkollë për ty, more vesh? Edhe sikur të vijë puna që unë sa për sy e faqe të të them vetë: «Shko moj nuse se të kam dhënë lejen», ti nuk do të pranosh. Sikur bota të përmbysset, ti nuk do të pranosh. Përndryshe, të thashë, të piu e zezë! Ti vetë nuk do të pranosh, kuptove? Jo se s'të lë unë, por se nuk do vetë ti! Nesër-pasnesër do



të pjell, thuaju, do të rris kalamajtë dhe kalamajtë që janë për shkollë, do t'i çoj në shkollë. More vesh? Hajt!

Mahiri iku dhe e la nusen të shtangur e të frikësuar. Sa i egër paskesh qenë ai, nuses së gjorë as që i kishte shkuar ndonjëherë ndër mend.

— Ç'ke sonte kështu? — e pyeti dhe e pyeti dy orë të tëra i shoqi në dyshek.

Po nusja dridhej e tëra e së fundi ja plasi të qarit dhe gjë nuk tregonte. Gati në të gdhirë, mezi e kandisi Kamberi që të rrëfente. Edhe ai vetë u çudit se sa të egër e paskesh pasur të atin. S'e kish-te njohur deri në atë pikë.

Si të bënte? Vrau mendjen, por asnjë rrugë nuk i dukej më e mira.

Kacabuni i vogël, Fasliu, me majën e hundës përpjetë, i ra erës se diçka po vlonte në shtëpi. Pyeti të ëmën, e ëma s'dinte gjë. Pyeti nusen e vëllait, nusja s'tregonte. Pyeti të vëllanë. Kamberi i tha kështu e kështu. I tha edhe se i ka dhënë karar të lajmërojë.

Kacabuni ja dha gazit, si të ishte e gjitha kjo një lojë qesharake.

— Mirë, — tha — por edhe fort merak mos u bëj. Po ta vrasim pak mendjen, ja gjejmë ilaçin edhe kësaj pune.

Kamberi e dinte se ç'çamarok e kishte të vëllanë, por në këtë rast ju duk kalama fare. Qeshi e i shpupurishi flokët.

Po atë ditë fronti bëri një mbledhje të fshatit. Ndër të tjera u ngrit edhe problemi i regjistrimeve në shkollë pa shkëputje nga puna. Disa dhanë fjalën që atje. Shumica heshtnin. Dikush filloi t'i nxis-te njerëzit që të mos heshtnin.

— Hë, ti, nuse e Kamberit, ç'thua? Apo nuk të lënë?

Mahiri kërceu nga stoli i inatosur:

— Matini fjalët, kur t'i nxirrni nga goja! Asnjë pengesë s'ka nga ne! Ja, faqe gjithë fshatit po i jap leje të regjistrohet që tani po të dojë.

— Hë, më të lumtë, Mahir Kacaturja! Ja, kështu. Merrni shembull, shokë, nga Mahiri! Edhe nusja e Kamberit do të regjistrohet, hë ju të tjerët...

— Me leje! — thirri nusja andej tej nga një qoshe, midis disa nuseve të tjera. — Unë nuk dua! Nesër-pasnesër unë do të pjell e do të rrit kalamajtë dhe kalamajtë do t'i çoj në shkollë. Unë vetë nuk dua. Nuk jam për shkollë unë.

Nusja u ul dhe i shpëtuan lotët.

Një plakë atje afër nuseve u revoltua e tha me zë të lartë:

— Mirë thotë nusja. Kjo s'është parë e dëgjuar! Ç'është kjo shkollë për gratë? Nuset janë për të pjellë, jo për t'u harbuar natën demek se nëpër shkollë!

Kur e mori vesh daj Rrapushi se ç'kishte ndodhur në mbledhje, ju shtua ymri e u krekos. U bë gati të shkonte në shtëpi të vëllait që t'ja shtronin me raki e ta digjnin për fitoren. Kur ja arriti kacakuni me një frymë.

— E, o nipçe, ç'kemi andej? — e pyeti has e gas daja, — Mahiri qysh është?

Faslliu si i mërzhitur tha:

— Mirë, mirë jemi, por babën e zuri një dhe mbje e madhe nga veshët mbrëmë, që thamë se vdiq. Sot nuk dëgjon më...

— Nuk dëgjon, the? Fare nuk dëgjon?

— Jo, fare-fare, jo. Po t'i thërrasësh shumë, dëgjon pak.

Daj Rrapushi u ngrys i tëri.

— Po kjo, — tha — mirë se unë e kam pasur me kohë këtë ilet, po Mahiri, s'është ankuar ndonjëherë nga veshët. Çudi për t'u çuditur, besa!

— E po vëllezër jeni — tha kacabuni.

— Unë thashë të vija nga mbrëmja, por po vij tani me ty — tha daj Rrapushi.

— Ti hajde ngadalë, unë po iki, — tha Faslliu — se kam një çikë punë në shtëpi të kulturës.

Dhe kacabuni vërtet e la vrapin në shtëpi të kulturës. I tha përgjegjëses:

— Nije, desha pak manjetofonin!

— Ç'e do? — i tha ajo.

— Shpejt, Nije, se s'pret puna!

Dhe kacabuni me një frymë i shpjegoi shoqes se pse s'priste puna. Me manjetofonin në dorë fluturoi drejt e në shtëpi. E fshehu manjetofonin dhe hyri në dhomë. Ata ishin shtruar e po hanin drekë.

— Nga bredh, ti more, edepsëz? — i tha i ati gjoja si me inat, por dukej që ishte në qejf.

— Isha te xhaja — tha kacabuni.

— E, si ishin ata andej?

— Mirë, mirë ishin, por xhajën e kishin zënë veshët mbrëmë më fort se asnjëherë tjetër dhe sot nuk dëgjonte fare. I thërrisje shumë që të dëgjonte pak!

— Hej të shkretën, ke do të shurdhohet fare ndonjë ditë ai! U dashka shkuar pak mbasdreke...

Kacabuni imitonte pikëllimin e të atit dhe u ul të hante drekë.

Këta pa u ngritur nga sofa, daj Rrapushi hyri në oborr.

«S'i është duruar të marrë vesh mirë punën e mbledhjes» tha me vete Mahiri.

— Qysh je, o-o-o-Mahir! — thirri fort daj Rrapushi. — Mirë mua, po ty ç'të gjeti kështu, ë, dë-gjon?

Kacabuni e nusja e Kamberit dolën jashtë nga dhoma. Pastaj doli edhe Kamberi me të ëmën.

Aq më fort ju përgjegj Mahiri:

— Hajde, o-o-o- Rrapush! Ulu, ulu!

Shtëpia buçiste si të flisnin nga altoparlanti. Kacabuni e Kamberi futën përsëri kokën në dhomë e u përshëndoshën:

— Mbeç me shëndet, xhaje! Ikëm ne, baba, se kemi mbledhjen e rinisë.

Dy burrat deshën të siguroheshin edhe nga nusja.

— Oj ti, nuse, — thirri Mahiri — mos na rri këtu me duar në gji, po dil e prashit ato misrat matanë pusit.

Kacabuni e kishte kurdisur manjetofonin lart në tavan të dhomës dhe i kërrusur mbi të mbante vesh kur do të fillonin, që të shtypte butonin.

Nga gëzimi i fitores, se e kishin mundur shko-llën, dy vëllezërit u ngjirën së bërtituri e thërrituri. Mahiri tregonte se si ja mblodhi frerin nuses, si foli me të, si foli në mbledhje, si e lavdëruan bile, si foli pastaj nusja. Daj Rrapushi shkëlehej duke qeshur me lot dhe bërtiste sa kishte fuqi:

— Ooo më të lumtë, o-o-o- Mahir!

Mahiri gajasej e i rrihte shpatullat të vëllait:

— Më rrofsh e më qofsh, o-o-o Rrapush!

Dhe mezi u kujtuan të pyesin njëri-tjetrin sepse bërtisnin aq fort.

— Bërtas, se s'dëgjon ti — tha Mahiri. — Kisha hequr të zitë e ullirit ti mbrëmë me veshët.

— Jo, ore, unë dëgjoj mirë, — tha daj Rrapushi — po ti që s'ke vuajtur kurrë, ç'pate?

Ah, kacabun, kacabun!

— Veç mos ardh të sonte në shtëpi, se do ta vdes më dru — shfryu Mahiri.

Të nesërmen fronti bëri përsëri një mbledhje të fshatit. Në fillim askush nuk e kuptoi se përse bëhej kjo mbledhje. Kryetarja e frontit u tha njerëzve se ishin mbledhur për të dëgjuar se si mundohet fryma e vjetër të pengojë revolucionin. Dhe njerëzit po prisnin kush do ta merrte fjalën. Por Nija hapi manjetofonin dhe shkeli me gisht butonin. Në sallë buçitën britmat e dy Kacaturëve.

Zëri i Mahirit:

«...Më ka ngelë aqë burrëri, i thashë, sa të ta shtyp kokën ty, i thashë. Këtu në shtëpinë time do të bëhet si them unë!»

Zëri i daj Rrapushit:

«O-oh-oh-oh! Një okë gjak më shtove, o-o-o Mahir! Ma shtove ymrin, ore, -e-e! Sa mirë ja paske bërë gjidi sojsëzes!»

Zëri i Mahirit:

«Sikur bota të përmbysset, i thashë, ti nuk do të pranosh të shkosh në shkollë! Jo pse s'të lë unë, i thashë, po do t'ua thuash që s'do ti vetë. Kush të të pyesë, i thashë, do t'i përgjigjesh, s'është shkollla për mua, unë do të pjell kalamaj...»

Salla u harbua qoshe më qoshe. Shumica shkulleshin gazit. Të tjerë hidhnin e prisnin thumba.

- Ore, ç'na qenka!
- Pushoni të dëgjojmë, de!
- Për nder, qenkan artista Kacaturët!
- T'i marrim në estradë, ore!
- Hajde rafinatë, hajde!

Të dy Kacaturët, mehitë në fytyrë, u pataksën dhe prisnin t'u hapej toka e t'i përpinte. Se si ju dha të dyve njëherësh e brofën në këmbë, bënë tutje përmes sallës që buçiste nga romuzet, të qeshurat e fishkëllimat dhe grysh dolën për dere përjashta.

- Një zë i fortë nga salla i shoqëroi:
- Turp!/

## AS LULET NUK ARRITËN TË ÇELIN

Kokat e njerëzve nxinin, zverdhonin, zbardhin në sallën e ngushtë dhe të gjatë. Diskutanti i katërt, shefi i administratës së ndërmarrjes, që kishite fjalën, nuk mund të vështronte veçse fytyrat e dy rradhëve të para. Ai lexonte lart në podium. Njerëzve u vështronte vetëm kokat e zeza, të verdha, të bardha. Midis gjithë atyre kokave seç vlon-te në hapësirën e sallës, një si gumëzhimë e shurdhër, që dukej sikur e udhëhiqte zëri i përgjumur i diskutantit. Po të mbyllje sytë e të mos shikoje ç'bëhej, do të kishe përshtypjen se po ekzekutohej diçka e çuditshme, ku merrnin pjesë lloj-lloj zërash të mbytur, që nuk dukeshin tamam zëra. Diskutanti pak i çjerrë drejtonte gumëzhimën e sallës. Ai vazhdonte:

— Para se të hyjmë në analizën e thellë shkencore të këtyre çështjeve, duhet, shokë, të kemi të qartë rëndësinë kolosale të këtyre problemeve të rëndësishme që preokupojnë administratën e ndërmarrjes, domethënë...

Gjatë leximit të kësaj periudhe në cepin pranë dritares së gjashtë të sallës dy koka të zeza e një

e verdhë u vërsulën pranë njëra-tjetrës, sikur do të përpiqeshin si deshët me brirë. Ishin tre djem që mbanin përpara nga një letër e nga një laps e diçka shënonin.

Kokëziu flokëshkurtër tha:

— Nëntëdhjetë e tre!

Flokëverdhi tha:

— Njëqind e shtatëmbëdhjetë!

Flokëgjati kokëzi tha:

— Njëqind e shtatëdhjetë!

Ata kishin kohë që diçka shënonin nga ato që lexonte diskutanti, por tani siç duket qeshën nga rima e numërave 117 dhe 170. Flokëshkurtëri numëronte sa herë përsëritej fjala «çështje». Flokëverdhi numëronte «rëndësitë» dhe ai tjetri «domethënat».

Në presidium drejtori detyrohej herë pas here të trokiste me laps në tryezë, kur kujtohej se zëri i diskutantit ishte mbytur krejt nga gumëzhina. Dhe shefi i administratës vazhdonte diskutimin. Edhe ata tre djemtë në sallë vazhdonin të shënonin «çështjet», «rëndësitë» dhe «domethënat».

Një kokë e bardhë, që ndodhej nga mesi i sallës, tundej sa para e prapa, sikur donte të këputej e të binte përdhë.

— E zuri gjumi xha Ismetin! — qeshi njëri që rrinte pas plakut që i varej koka.

— Ka hak. Kështu si e kanë nisur këta, do të na zërë mesi i natës — tha tjetri pranë tij.

— Opo s'jam në terezi unë, apo vërtet u lodhëm? — pyeti një tjetër.

— U këputmë, jo u lodhëm! — e korigjoi një grua trashaluqe.



Një grup nga ana e djathtë e sallës kishte nxjerrë librat dhe lexonte. Pas tyre katër-pesë gra i qanin hallin njëra-tjetrës për kalamajtë. Pastaj kthyen pllakën nga ana tjetër dhe nisën me copat për fustanet verore e me llojet e dantellave që kishin dalë në shitje. Njëri nga ata që lexonte para këtyre grave, u kthye e u lut:

— Shoqe, mundësisht me ngadalë, pasi s'po marrim vesh gjë.

Gratë qeshën.

— E shohim, e shohim — thanë.

Njëra tha:

— Pse, o çuna, katër orë nuk po sqaroheni dot këtu në mbledhje, por keni hapur edhe librat?

— Kemi shkollë nesër mbrëma.

— Po pse, këtu gjetët të përgatiteni?

— Po kur të përgatitemi?

Në të majtë të sallës nja dy veta mbllaçiteshin.

— Ç'po hani ashtu, ore? Amani, na jepni ca, se na griu!

— Farë luledielli. Doni?

— Aman, o të keqen!

— Jepnani edhe ca, se kërkojnë edhe këta pas!

Dorë pas dore u krijua një skuadër e fortë mbllaçitësish.

Pak më nga fundi një kokë djali avitej pranë një koke vajze dhe i pëshpëriste në vesh.

— Dua të të them një gjë shumë-shumë të rëndësishme.

— Thuaje — i tha vajza.

— Sidoqoftë, mos u zemëro, — i tha ai.

— Po qe fjalë e mirë, pse të zemërohem? — u përgjegj vajza.

Ai i tha:

— Ti e di ç'dua të të them.

— Jo, nuk e di.

Vazhduan edhe ca kështu, «e di, s'e di», derisa djali i tha:

— Të dashuroj!

— Mirë, — tha vajza — po këtu e gjete të më propozosh?

— Po ku? — u ankua djali.

Nga një qoshe e sallës dikush hapi gojën sa një kamare dhe gogësiu aq fort si të kishte dashur të jepte alarmin në sallë. Por sirena e gogësitjes u dëgjua aq tepër qesharake, sa në sallë plasi gazi.

Shefi, që vazhdonte diskutimin, i lodhur, fshiu djersët me shami. Drejtori trokiti lapsin në tavolinë. Të qeshurat kësaj radhe nuk pushuan nga trokitja e lapsit. Atëhere nga rrjeshti i parë i karrigave u ngrit në këmbë kryetari i bashkimeve profesionale dhe ju kthye sallës. Që nga vetullat duket se ishte nxehur e inatosur fort. Dhe thirri me të madhe:

— E po kjo nuk durohet, o shokë!

Por në atë çast dikush thirri nga salla për t'i ardhur në ndihmë kryetarit të nxehur e të inatosur:

— Ashtu është. Për nder, nuk durohet! Ç'janë këto diskutime mbush e derdh? U ngopëm, o të shkretën me ujët! Mjaft më.

Ilaritet në sallë!

Shefi i administratës në podium gjeti rast dhe mbushi gotën me ujë. Siç duket i ishte tharë pësh-tyma.

— S'të pëlqen ty, shoku Sotir? — u tartaros më keq kryetari. — Ë, si thua?

— Them t'i japim fund, se po na bie të fikët  
— ja pat Sotiri pa u çuar fare nga vendi.

— Domethënë ti e nënvleftëson këtë mbledhje kaq me rëndësi — tha kryetari duke vështruar drejtorin në presidium për të fituar pikë.

— Është fare pa bukë kjo mbledhje — nguli këmbë Sotiri. — A shtrohet tavolina vetëm me ujë? Ti vetë the se nuk durohet më.

Kryetari e gjeti veten ngushtë dhe ju drejtua masës:

— Si e gjykoni ju, shokë, qëndrimin e Sotirit? Dikush u çua e tha duke qeshur:

— Mos kaloni në pikë tjetër, shoku kryetar. Kemi në diskutim nëse ka apo s'ka bukë kjo mbledhje.

Për të shpëtuar nga halli që e zuri kryetarin dhe për të vendosur autoritetin e presidiumit, u çua drejtori. Trokiti fort me laps në tavolinë dhe tha:

— Ç'është kështu, xhanëm? Pse ngrini diskutime pa vend? Mbledhja ka rëndësi, se bëhet për të ndarë me ju kolektivin, përgjegjësitë tona si administratë e drejtori. Cili nuk është dakord me këtë?

— Ne, shoku drejtor! — thirri njëra nga salla.

Ndërkohë, ajo pa u çuar ende në këmbë dhe posa drejtori hapi gojën të pyeste se kush që ajo që kundërshtoi, nga jashtë hyri nënkryetari i bashkimeve profesionale.

— Me leje? — tha ai. — A mund të marr pjesë?

Njërit prej atyre që hante farë lule dielli ju shkrep të kërkonte llogari:

— Unë mendoj ta diskutojmë çështjen a të marrë apo të mos marrë pjesë shoku Midhat në mbledhje, sepse ka ardhur me shumë vonesë.

Nënkryetari, atje ku ishte në këmbë pranë derës, i habitur hapi krahët si për të kërkuar ndihmë e tha:

— Ç'ka për të diskutuar këtu, more vëlla i dashur? Unë nga mbledhja po vij, Bile këtu duhet të qëndroj vetëm një orë e gjysmë, pasi kam një mbledhje tjetër pas dy orësh.

Se kush thirri andej nga fundi:

Paska edhe më keq! Parashikimet qenkan që mbledhja të vazhdojë mbi një orë e gjysmë!

U mpleks keq puna.

Kryetari priste në këmbë të gjente radhë për t'i kërkuar llogari Sotirit. Drejtori bënte të gjente shteg midis zërave që hidheshin e priteshin në sallë për të kërkuar cila që ajo që guxoi t'i kundërshtonte. Nënkryetari nuk ulej, se priste të vendosej çështja e tij, të merrte pjesë apo jo në mbledhje. Kurse shefi i administratës, me dosjen plot me fletë të shkruara të diskutimit të tij, pasi kishte pirë edhe një herë tjetër ujë dhe pasi numëroi me nge sa fletë i kishin mbetur ende për të lexuar, kërkoi leje të thoshte edhe ai nja dy fjalë jashtë fletëve të diskutimit në dosje.

Si për çudi të gjithë heshtën.

Shefi tha:

— Desha të plotësoja mendimin e shokut drejtor që tregoi më së miri rëndësinë...

Ai djali flokëgjatë harroi e bërtiti:

— Treqind e tetëdhjetë e dy!

Njerëzit kthyen të gjithë kokat nga djali. Dikush pyeti:

— Ç'pate, or çun, ti sikur ishe mirë!...

Diskutanti kishte thënë edhe disa fjalë që s'i

dëgjuan njerëzit. Posa drejtuan përsëri vëmendjen te shefi, ai po thoshte:

— ... Duhet të dimë dhe ta ngulim mirë në tru, se vetëm nëpërmjet mbledhjeve, konsultave, konferencave, takimeve etj. etj. sado të mërzitshme që të na duken, arrihet lidhja e kuadrove me masat, arrihet zbatimi i vijës së masave, njohja e mendimeve të masës, domethënë...

Katërqind e tetëdhjetë e tre! — thirri ai djali tjetër që numëronte «domethënat» e që mendoi se do të kishte sukses si shoku i tij, por kësaj radhe atij s'ja vari kush.

U ngrit një grua dhe ju drejtua shefit që priste me fletët përpara të vazhdonte diskutimin e tij.

— Po qe se doni të njiheni me mendimin e masës, atëhere dëgjojeni: mbledhje si kjo, ku thuhet shumë gjëra për të mos thënë asgjë, nuk duam më, pasi nuk japin asnjë frut.

— Qyqja, moj Nurije, — ja pat një grua tjetër atje pranë — t'u hëngëkan edhe kokrrat! Ne vdiqëm këtu dhe s'pamë të çelë asnjë lule!

## MIRË NA E BËRE, O DAUT!

Kur mbeteshin ngushtë, përplaseshin te Dauti. Dauti nuk ishte as më plaku, as më i riu në fshat. Ai mbante mustaqe dhe kishte hundën si sqep shqiponje. E gjeje në punët më të vështira të kooperativës, prandaj e nderonin të gjithë.

Ishte në fund të kanalit kullues e i mëshonte belit, kur erdhi kryetari i këshillit popullor.

— O Daut!

— E!

— Kemi rënë në hall. Banjot i ngritëm, por siç e di edhe ti, po mbushen dy muaj dhe njeri s'bën këmbë të shkojë e të lahet.

— E...

— Them se, po të shkosh ti, do të shkojnë edhe të tjerët.

— E.

— Si thua, o Daut?

— Mirë, si të doni. Po shkoj sot pas pune.

— Hajt, me krahë të lehta e tungjatjeta!

— Tungjatjeta.

Kryetari iku. Dauti e fluturoi baltën e zezë dy metra lart në sop të kanalit dhe përsëri i mëshoi belit.

- Erdhi pas një ore nënkryetari i kooperativës.

— Punë e mbarë, Daut!

— Mbarë paç.

— Kemi rënë në hall. Njerëzit nuk lahen.

— Lahen, lahen — tha Dauti.

— Lahen, por nuk lahen në banjot e kooperativës.

— E, po.

— Ja, ti i pari, nuk shkon.

— Vërtet nuk kam shkuar.

— Po pse, o Daut? Ti rëndësinë e di, s'ke nevojë për agjitacion.

— Nga mukajeti, o Selim.

— Bën mirë ta thyesh këmbën e shejtanit, që të vijne edhe të tjerët.

— Mirë thua. Po shkoj sot pas pune.

— Vërtet?

— Vërtet.

— Fjala fjalë?

— Llaf! llaf!

Nënkryetari iku. Dauti u kërrus e i mëshoi belit. Dielli u ngjit edhe një hosten, kur erdhi në buzë të kanalit përgjegjësja e gruas.

— Na polli, o Daut!

— E po gratë do të pjellin, o Leme, pse çuditësh?

— Mos u tall, ore ti. Na polli me konceptet. «Kur nuk shkojnë burrat të lahen në banjot e kooperativës, thonë gratë, do të shkokemi ne?»

— Mirë thonë.

— Oj, mirë thonë. Ja, ti pse nuk shkon, të marrësh me vete edhe Zajen.

— As unë s'e di.

- O Daut, mos u tall.
- Po ç'të bëj?
- Ja, të shkosh në banjo me Zajen e të shikosh, kur të mësohen e të vijnë të gjithë.
- Mirë, moj Leme, meqë ma fute në mend ti, po shkoj sot pas pune.
- Me gjithë Zajen të shkosh.
- E po e!
- A më të lumtë, o Daut.
- Hajt me të mira!

Përgjegjësja e gruas iku. Dauti vazhdonte punën. Pas pak ja behu infermieri; pas infermierit drejtori i shkollës; pas drejtorit të shkollës sekretarja e rinisë; pas asaj një tjetër, pas këtij tjetrit edhe një tjetër e një tjetër derisa nga qendra e kooperativës ra çanga, se dielli po perëndonte tutje e po zhytej të ftohej në det. Dauti la punën. Me belin në sup u kthye në shtëpi. I tha së shoqes të bëhej gati, se do të dilnin andej nga qendra e kooperativës. Vetë drodhi një cigare dhe vuri buzën në gaz.

Te banjot e reja të kooperativës ishin mbledhur e po prisnin Dautin me ceremoni kryetari i këshillit, nënkryetari i kooperativës, përgjegjësja e gruas, infermieri, drejtori i shkollës, sekretarja e rinisë dhe ata të tjerët.

Sa bëri ballë Dauti me të shoqen, Zajen, ai që i pa i pari, thirri:

— Dauti!

Të tjerët çakërritën sytë dhe të gëzuar thirrën:

— Dauti!

— Dauti bashkë me gruan!



— Dauti!

Dukej si një ceremoni solemne. Të gjithë sa ishin mbledhur atje, e tokën me Dautin e me të shoqen. Hunda si shqiponjë, mustaqet e zeza, e gjithë fytyra e shtërmadhe e Dautit ndritte nga një gaz i papërmbajtur. I hodhi një sy ndërtesës së re të banjove. Ishte stolitur me shtatë parulla mbi higjenën, pastërtinë e shëndetin. Përgjegjësi i banjove të burrave priste me blok në dorë. Edhe në anën tjetër përgjegjësja e banjove të grave ishte gati me blok në dorë.

— Mirë se na erdhe e me këmbë të mbarë, o Daut — e përshëndetën.

Dauti i tha përgjegjësit të banjove:

— A e ke ngrohur ujin mirë, o Latif?

Mirëpo Latifin s'e lanë të përgjigjej, se u hodhën kryetari i këshillit, nënkryetari i kooperativës, përgjegjësja e gruas, infermieri, drejtori i shkollës, sekretarja e rinisë e ata të tjerët, kush e kush më parë, në kulmin e entuziazmit, i dhanë përgjigjen Dautit:

— Janë me korrent, o Daut!

— Ngrohët vetë, o Daut, sa ta lëshosh!

— Pse, ore, ç'kujtove ti, si në shtëpi, me kazan e me susak?

— Ha-ha-ha! Me korent, ore, me korent...

Dauti në fillim qeshi bashkë me ta, pastaj bëri sikur u ngryso.

— Me korent? — pyeti.

— E po e, me korent.

— Domethënë me korent elektrik.

— Ashtu, posi.

— Domethënë të më dredhë e të më përplasë tej! — tha Dauti.

— Këtu nuk të dredh. Korenti ngroh ujin, po nuk të dredh.

— E kanë bërë hesap ata që e kanë shpikur këtë punë, o Daut.

— Mos ki frikë, se s'ka asnjë rrezik, o Daut. Dauti mbajti gazin që i vlonte përbrenda e tha serioz:

— Aha! S'e ha atë kokërr ulliri unë... Me korentin s'bëhet shaka. Prandaj nuk ardhkan njerëzit të lahen këtu.

— Ore, mos u bëj tuaf. Këto janë banjo moderne, por njerëzit nuk vijnë se i pengojnë konceptet.

Dauti pyeti:

— Të zë apo s'të zë korenti?

— Jo, ore, nuk të zë hiç fare! — tha kryetari i këshillit.

— Je larë ndonjëherë ti këtu? — e pyeti Dauti.

— Jo — tha kryetari i zënë ngushtë.

— E po ç'më llafosesh kot pra? — tha Dauti.

U hodh drejtori i shkollës:

— Ore, Daut, unë jam i fizikës. E di mirë këtë punë. Nuk të zë. Mos u bëj çilimi. Të siguroj unë.

— A je larë ti, këtë më thuaj! — nguli këmbë Dauti.

Drejtori u nxeh e tha:

— Unë shkoj javë për javë në qytet e lahem në shtëpi, ore. Ja, kështu e kam dushin, me korent.

— Këtu, këtu — nguli këmbë Dauti. — Pse të shkosh çdo javë në shtëpi e të na i lësh punët zvarrë këndeje?

Drejtorit i ngeci pështyma në fyt. Askush nga të tjerët nuk po fliste më. U bë një heshtje e rëndë.

— E, more shokë, pse s'flisni? Apo ju pengojnë konceptet?

Zaja ju drejtua shoqeve:

— E, moj shoqeni, ç'keni që ulni kokën të turpëruara?

Dauti ja shkrepiti gazit e tha:

— E po jemi që jemi, a ja nisim me këmbë të mbarë, o shokëni? Hajde, kryetar, prina!

Kryetari psherëtiu:

— Mirë na e bëre, o Daut. Po shyqyr që jemi tanët e që s'ndodhi njeri i huaj, se do të ishim fëlliqur fare.

Dhe kryetari preu biletën i pari.

## NJERIU I PADUKSHËM

Për shokun Hamdi, nëndrejtorin e ndërmarrjes, shumica dukej sikur kishte respekt. Pakica sikur e kishte frikë. Shoku Hamdi po mbushte plot njëzet vjet në atë detyrë. Drejtorët venin e vinin, kurse shoku Hamdi ishte më i vjetri nga të gjithë në ndërmarrje. Por meritat e tij ai mund të ishte bërë nëntëmbëdhjetë herë drejtor, por nuk donte vetë. Dhe kështu thuhej se ai ishte armik i karrierizmit. Ishte i thjeshtë. «Edhe të ecurit, thoshin, e kishite popullor.»

Karakteristika themelore, që spikaste mbi të gjitha te shoku Hamdi, ishte lufta e papajtueshme dhe e vazhdueshme që ai i kishte shpallur burokracisë dhe qëndrimi i tij mbi «vogëlsirat». Në këtë front ai dallohej si trim me fletë.

— Më dridhen leqet e këmbëve prej tij! — u thoshte shokëve shefi i administratës me zë të ulët.

Kishte të drejtë xha Mahmuti. Administrator me një barrë eksperiencë që nga koha e baba Qemos ishte tmerruar kaq e kaq herë nga urdhërat e prera të shokut Hamdi që të mos i regjistronte

të gjitha shkresat e hyra e të dala në librin e protokollit. Të regjistronte vetëm gjysmat.

«Po më vjen rrotull, do të më shkurtojë fare ndonjë ditë... , dridhej xha Mahmuti. Ç'punë do të bëj unë po nuk i regjistrova në protokoll të gjitha shkresat? pyeste me ankth vetëveten xha Mahmuti. Do të më nxjerrë në pension!» mjerohej xha Mahmuti.

Dhe vërtet një ditë shoku Hamdi e ngriti me forcë në mbledhje çështjen e shkurtimeve të vendit të xha Mahmutit. Xha Mahmutit po i dridhej buza tek vriste e priste shoku Hamdi në mbledhje, po, kur ishte gati për t'i rënë të fikët, dëgjoi fundin e ligjëratës së zjartë «revolucionare» të shokut Hamdi që tha:

— Pra, vendi i xha Mahmutit është i tepërt. Ne duhet ta suprimojmë menjëherë këtë hallkë të panevojshme të administratës sonë të fryrë. Do të zbatojmë me përpikmëri dhe pa asnjë lëshim direktivat. Sa për çështjen e xha Mahmutit, ai ne na duhet, sepse, do të thosha se është i pazëvendësueshëm në punën e tij. Ai do të vazhdojë të kryejë punën e tij, por në organikë do të figurojë si roje nate.

Xha Mahmutit nuk i ra të fikët.

Zakonisht, nëpunësit e administratës së ndërmarrjes dilnin rreth orës dhjetë të mëngjezit për të pirë kafe, ndërsa shoku Hamdi dilte në mënyrë parimore në orën dymbëdhjetë. Këtë parim ja kishin vënë re punëtorët dhe çdo ditë e prisnin «rastesisht» dy a tri në oborr, ose te porta e madhe për të qarë hallet e tyre, sepse në zyrë shoku Hamdi kishte shumë punë. Aq punë kishte, sa edhe ora-

rin e pritjes e mbante sekret. Orari i pritjes së shokut Hamdi (një herë në dy-tri javë ose në muaj) mund të merrej vesh vetëm me anë të mikut. Prandaj shumica që nuk kishin miq dilnin dhe e prisnin «rastësisht» në orën dymbëdhjetë, kur shkante të pinte kafën, ose në orën 13, kur kthehej nga kafe-neja.

I ankohej i pari:

— Mos ki merak! Brenda javës ka marrë fund. E rregulloj unë këtë punë. Hajt, tungjatjeta! — u përgjegjej shoku Hamdi dhe bënte tutje.

E priste i dyti.

Përgjegjej shoku Hamdi:

— Ke shumë të drejtë! Ju marrin frymën këta burokratët e mykur. Lëre në dorën time këtë çështje. Hajt, mirë u pafshim!

I sulej i treti.

— Posi! Të kërkosh llogari gjer më një — përgjegjej shoku Hamdi. — Do të ndërhyj unë personalisht. Hajt, tungjatjeta!

Dhe shkante shoku Hamdi të pinte kafe plotësisht i kënaqur nga operativiteti i tij. Pas një ore «rastësisht» në oborrin e ndërmarrjes e sulmojnë të tjerë hallexhinj. Dhe shoku Hamdi, gjysmë i lodhur, gjysmë i mërzitur, gjysmë i shpejtuar nga punët e mëdha, përgjegjej:

— Si! Akoma ti! Shko rri i qetë, se po të them unë i pari je në listë. Hajt, tungjatjeta!

— Ngreje në mbledhje të kolektivit, se mua më ke pro! Hajt, tungjatjeta!

— Eja nesër në zyrë, ta firmos unë. Hajt, tungjatjeta!

Dhe kështu dukej sikur shumica kishte respekt

për shokun Hamdi, megjithëse çuditërisht hallexhij-të që prisnin «rastësisht» rreth orës 12 deri më 13 nëndrejtorin e respektueshëm parimor, shtoheshin dita-ditës. Çudia ishte shumë e madhe dhe fare e thjeshtë. Hallet e njerëzve mbeteshin atje ku kishin nisur. Por shokut Hamdi çuditërisht dukej sikur i shtohesh respekti. Dhe çudia ishte përsëri shumë e madhe dhe fare e thjeshtë. Sepse shoku Hamdi, me takt, u jepte «sqarime» të tipit «operativ».

— Unë bëra çmos, por do ta marr edhe një herë në dorën time këtë çështje. Hajt, tungjatjeta!

— Si! Akoma s'e paskan zbatuar urdhërin tim! Së shpejti do ta shikosh se do t'u bëj gjëmën burokratëve të mykur! Hajt, tungjatjeta!

Shumica që dukej sikur kishte respekt për shokun Hamdi, e kishte të vështirë t'i kapte veprimet «operative», plot «inisiativë» të nëndrejtorit me të ecur popullor, kurse lexuesit dhe të tjerët, që nuk kanë pasur halle për të qarë as punë për të zgjidhur me shokun Hamdi, e kanë të qartë vetinë e tij që thamë në fillim, se shoku Hamdi «ngrihej mbi vogëlsirat». Ai njihej si mbrojtës i flaktë i parimeve dhe i ligjeve.

Por edhe atje, midis shumicës që kishte respekt për nëndrejtorin që ecte rrugës në mënyrë popullore, gumëzhinin mjaft zëra nga ata të «kokëshkretëve», të cilët nuk lodheshin e nuk nënshtroheshin, kishin kurajo e merrnin guxim herë pas here për të vënë në dukje ato gjëra që nuk dukeshin te shoku Hamdi.

Atëhere nëndrejtori, që kishte një të ecur krejt popullor, kërcente nga karriga në mënyrë aspak popullore dhe çirrej në mënyrë «parimore»:

— Ne, që na kanë vënë këtu, jemi klasa, jemi pushteti! Ka kush gjë për të shtuar gjë tani?

Kështu qe bërë për shumë kohë shoku Hamdi i padukshëm. Por njerëzia zgjohet, shkenca përparon. Mjetet për zbulimin e njerëzve të padukshëm po i përvetësojnë të gjithë. Dhe një ditë prej ditësh, kur shoku Hamdi mendonte se kishte arritur kulmin e përsosmërisë së njeriut të padukshëm, u gjet i zbuluar, krejt lakuriq, nën vërshimin e qindra shigjetave të zjarra. Ngado që kthehej shoku Hamdi, ngado që përpëlitej, e mbërthenin dhe e gozhdonin. Së fundi e pa veten përpara fshesës së zjarrtë që e rrokullisi tutje:

«Hajt, tungjatjeta, shoku Hamdi!»



## KRAHU I VLLASIT DHE SHPATA E SHËN MËHILLIT

U ngritëm ne, rinia e fshatit, para disa vjetësh dhe vendosëm të prishnim kishën. Plasi sherri gjithandej. Plasi edhe në familjen tonë. Gjyshja, babai, nëna, ngritën duart nga qielli. Kërkonin ndihmë për të shkukur kthetrat e satanait nga zemrat e neve të rinjve. Unë e ime motër qeshnim e sulmonim zot, kishë e shën Mëhill. Vëllai i madh me nusen dukej sikur nuk mbanin as andej as këndeje, por ne e kuptonim se me fjalë u bënëin qejfin pleqve, kurse me zemër ishin me ne.

Gjyshi hakërrohej:

— Mosni, se do të na përmbysni. Do të bëhet hataja e do të dalë ujë i zi nga toka... Do të rrjedhë shi gjaku e do të na përfshijë lubia. Mosni!

Gjyshi mbante flamurin e fesë në fshat, pas priftit e qisharit.

Gjyshja shfrynte e mallëkonte:

— Pse ja mbërrimë kësaj dite! Të kishim ikur me kohë në atë botë e të mos na shihnin sytë ditën e kiametit.

Nëna lutej:

— Amani, mos vini dorë të parët, se do t'ju ngurosë shën Mhilli...

Kurse ne rrëfenim gazmore për priftërinjtë e për mësimet e ungjijve. Dhe ndizej sherri keq. Dhe kështu erdhi dita e caktuar.

Në shtëpinë tonë ra zija. Vajtme e lutje përpara ikonës. Vëllai i madh i nxori hall vetes dhe iku që me natë në qytet bashkë me të shoqen, gjoja për të bërë radiografi. Unë e ime motër e lamë vrapin në shtëpinë e kulturës.

U mblodh atje pothuaj gjithë fshati. Kishte edhe pleq që ishin me ne, rininë. Kishte edhe sehirxhinj. Dhe u nisëm karvan me orkestër në ballë, me këngë e brohoritje si në ditë feste.

Kisha e bardhë e shën Mëhillit na dukej atë ditë së largu midis fushës sikur ishte fshehur më shumë midis selvive e dafinave. Karvani i gëzuar i njerëzve u afrua dhe e rrethoi.

Shpërthyem dyert dhe u vërsulëm brenda. Për një çerek ore në oborr të kishës u ngrit flaka në qiell nga grumbulli i shenjtorëve. Unë me shokët e mi mezi shkulëm shën Mëhillin dhe e nxorëm jashtë. Kërcënimi i tij hipur mbi kalë e me shpatë në dorë, në dritën e diellit e të flakëve të shokëve të tij që digjeshin me tërsëllëm, dukej fare qesharak. E vërtitëm midis flakëve dhe ai na la shëndënë.

Eh, ç'ka vajtur atë ditë!

Sehirxhinjtë së largu dhe ndonjë tjetër midis tyre, që prisnin duke bërë kryq të përmbysëj bota, përhapën lajmin se asnjëri nuk u nguros, asnjëri nuk u gërvish, shën Mhilli u dogj me devocion e s'bëri as gëk as mëk.

Besimtarët, të regjur, të heshtur e të ngurosur faleshin vrimave përpara ikonave dhe bisedonin me zotin. Kërkonin llogari të llahtaritur:

«Si nuk bëri gjë as shën Mhilli?»

«Kur s'lojti sëpatën shën Mhilli, kush do ta luajë?»

«Ruajna, zot, se po biem në mëkatë, të ketë hak vallë rinia?»

Pale kur ja behu i zemëruar papu Vllasi, i hollë e i gjatë, me krahët si cfurqe, së bashku me qisharin, xha Dhimon, trashalug, bythë e krye bashkë, të mbytur në djersë, ndërsa ne pothuaj i kishim larë hesapet me zotin shën Mëhill e shtëpinë e tij të bardhë.

Kapën kryetarin e kooperativës:

— Kryetar, ç'është kjo që po bëni, kryetar?

— E, vërtet, ashtu, ç'është kjo? — përsëriti xha Dhimua rumbullak pas shpinës së paput.

Ja, tek i ke, pyeti! — tregoi me dorë kryetari njerëzit rreth e rrotull që nxirrnin ikonat e fundit e i hidhnin në zjarr e të tjerët që këndonin e vallëzonin.

— S'kam punë me këta unë, — u nxeh papu — ty të njoh. Ti je kryetari.

Paput i dridhej mjekra. Disa u mblodhën grumbull të dëgjonin.

— E, — tha qishari me gushën varur dy pëllëmbë — ata s'i njohim ne. Ti je kryetari.

Unë jam kryetar i kooperativës. Këtu nuk jam kryetar. Jam si gjithë të tjerët.

— Ama, do e llafose ti? — ju drodh mjekra si çekiç paput. U largua tym duke kërkuar me sy mi-dis turmës.

— Ashtu, do e llafoset — tha qishari dhe i shkoi pas paput.

Gjetën sekretarin e partisë.

— Meruni vesh me popullin — u tha sekretari. — Unë këtu s'jam sekretar, jam si gjithë të tjerët.

— Qenkeni në një llaf! — kërciti dhëmbët papu Vllasi.

— Në një llaf, në një llaf — tha xha Dhimua.

— Ashtu është — tha sekretari ëmbël-ëmbël.

Dhe papu nuk ishte aq budalla. Uli zërin. E ëmbëlsoi edhe ai. Tha:

— Edhe unë me popullin jam. E prishën, e prishën. I dogjën, mirë, i dogjën. Nuk e kam këtu hallin.

— Nuk e kemi këtu hallin — tha edhe qishari.

— Po atëhere, ku e keni? — pyeti njëri nga grumbulli i kooperativistëve.

— Pse të mos na lajmronit ne? Ja këtu e kam! — thirri me inat papu Vllasi. — Ne kemi edhe plaçkat tona personale këtu. Pse nuk na lajmëruat?

— Posi, kemi plaçkat tona — tha qishari.

Ju vërsulën disa zëra tallës:

— Plaçkat janë të popullit. Ne syleshërit jua kemi sjellë.

— Ku i keni plaçkat ju, more?

— Mjaft keni rrjepur!

Paput i mori erë rasoja duke u rrotulluar midis grumbullit të njerëzve. Thirri sa pati në kokë:

— Kemi ore, si s'kemi? Jorganë, dyshekë, enë, gjëra të tjera... tonat!

Të gjithë ja plasën gazit.

Dikush thirri me inat:

— Lërimi lapangjozët të zhvasin ndonjë leckë.

— E, o, lerini, se s'na duhen...

Aty për aty u krijua nga ne një komision prej tri vetash. Hapëm çelësin e dhomës në aneksin e kishës. Papu si i tërbuar deshte të rrasej brenda, por qishari, që i rrinte pas, e tërhoqi nga rasoja dhe u vërsul të hynte vetë i pari. Kjo s'qe gjë fare. O po ç'na panë sytë e ç'jemi shkullur gazit ne të komisionit që i pamë. Lloj-lloj ndeshjesh kemi parë, por kacafytjen e dy qenërve, kush e kush t'i rrëmbejë kockën tjetrit, që kemi parë atë ditë, nuk do ta harrojmë. Edhe sot kur e kujtojmë, na zë gazi e qeshim me lot. Ne ua rryfyem më vonë këtë skenë kujt mundëm, por ç'e do, duhej ta shihje vetë me sy!

Kështu mbaroi puna e shën Mhillit të fshatit tonë dhe të ortakëve të tij! Mbyllëm një plagë të madhe. Ajo kishë ishte bërë qendër mashtrimi e ndyrë. I kishin nxjerrë namin prej kaq vjetësh sa bënte çudira. Memecëve u vinte goja, sakatët e të sëmuret shëroheshin, të marrët shndërroheshin në filozofë, gratë shterpa bëheshin pleja... mjafton të sillnin peshqeshe për papu Vllasin, më falni, për zotin shën Mëhill e të flinin një natë nën këmbët e kalit të tij. Nga të gjitha këto profka vetëm një gjë doli e vërtetë. Si stallë ajo ishte mjaft e ngrohtë dhe viçat e kooperativës rriteshin aty si kolopuça.

Pas kësaj as varrezat atje pranë stallës së viçave nuk shkonin, por ato mbetën që mbetën atje.

Një javë, dy, dhe papu Vllasi, pa ç'pa, hoqi rason e kamillafin, rroi pupën e qimeve të rralla majë mjekrës dhe doli në brigadë si të gjithë mëkata-

rët e tjerë të kësaj bote, për ta fituar bukën me djer-sën e ballit. Xha Dhimua doli «në pension».

— Kështu thamë të gjithë, se mori fund feja në fshatin tonë. Kur nuk shkoi shumë dhe vesh më vesh disa gallofë e disa kukuvajka nisën të pëshpërisnin:

— Dale, dale! Dardha e ka bishtin prapa.

— Gjetën shesh e bënë përshesh, se shën Mëhilli me shenjtorët e tjerë nuk ishin këtu.

— E ku ishin?

— Ishin në luftë, në Vietnam.

— Mos, more?

— Pa kur të kthehen, ka për të vajtur gjaku deri në shalë të kalit të zotit shën Mëhill!

— Hë-hë! Perëndia vonon, po nuk harron. . .

Bënte ç'bënte ndonjë dhe takonte Vllasin rrugës:

— Ç'thua ti, papu?

— Unë s'them asgjë këtu në rrugë. Unë këtu në rrugë nuk jam papu — përgjegjej ftohtë e ngrysur kooperativisti i thjeshtë Vllas dhe përgjonte rrotull mos e vinte re njeri.

— Na mëshiro, o zot. . . Bekona, o papu ynë. — i pëshpërisnin me zë të ulët gallofët e fshatit tonë.

Vllasi i ngrysur e i ftohtë ku nuk gjendej duke tundur krahët si cfurqe. Dhe gallofët e kukuvajkat faleshin e luteshin tinëz përpara ikonave të fshehura. Nisën të shtoheshin qirinjtë nëpër varret pranë stallës së viçave. Filluan të vërshonin peshqeshet me kanistra në varrezat pranë stallës së viçave.

— Të vdekurit do t'i kujtojmë! — përgjegjej kush e kush.

Ne nuk ishim kundra që t'i kujtonim të vdekurit, por këta qirinj e këto peshqeshe që grumbulloheshin në vorreza, kush i shpikte?

Na ra era se qirinjtë digjeshin nëpër gurët e varreve, kurse peshqeshet ngriheshin e i merrnin të vdekurit natën e ja dhuronin shën Mhillit që shëntiste me kalë pa plang e pa shtëpi.

Vendosëm të shihnim me sytë tanë, se si ngriheshin të vdekurit natën. Vajta unë me sekretarin e rinisë. Hymë në stallën e viçave. Ishte natë e bukur me hënë. Viçat përçapeshin në errësirë. Ne përgjornim varrezat. Shquanim mirë një kanistër me kapul te kryet e një varri. Ja ngulëm sytë atij varri e asaj kanistre, ku digjej edhe një qiri mbi gur. Nata ishte e qetë dhe midis saj ne shquam hijen e gjatë të një të vdekuri që po ecte midis varreve.

— Po vjen këndeje — thashë unë.

— I bie erë kanistra — tha sekretari.

— Edhe të vdekurit paskan hajdutë në mbretërinë e tyre! — thashë unë duke qeshur lehtë.

— E dallon dot se cili është?

— Prit të afrohet edhe ca — thashë unë.

— Më duket si papu — tha sekretari.

— S'është papu, — qesha unë — është dora vetë Vllasi.

Ndërkaq hija e Vllasit të gjatë u kërrus, mori kanistrën, e zbrazi në një thes. E la kanistrën përsëri në vend, mori thesin, e hodhi në krah dhe nisi të kërcente pupthi midis varreve. U zhduk në errësirë.

— Të bëfshin mirë, o Vllas! — qeshëm ne atje në stallë të viçave.

Të nesërmen thirrëm tim gjysh që mbante flamurin e gallofëve besimtarë të fshatit. I treguam kështu e kështu. Gjyshit i kërcyen dreqërit në kokë dhe nisi të shkumëzonte. Nuk na besonte.

— Eja ta shohësh me sytë e tu — i thamë.

Kërcente gjyshi e s'lidhej. Vetëm nga inati u kandis.

— Mirë, — tha — ama ta dini!

— Të na pështysh në sy, faqe tërë fshatit, — i thamë — ama po. . .

— Atë e di vetë unë! — e preu shkurt gjyshi.

E dërguam gjyshin në stallë të viçave. Unë dhe sekretari i rinisë shkuam pas dritës së një qiriu që digjej te kryet e një varri pranë një gëmushe të madhe dafinash. Kishte kanistër? Kishte. Me majë bile, e mbushur plot.

— Na shquan se ku jemi? — pyetëm gjyshin.

— Po, po! — tha gjyshi nga stalla.

Ne të dy u fshehëm midis gëmushës së madhe. Prisnim. Priste dhe gjyshi atje duke përgjuar. Nata ishte e bukur e me hënë. Bulqthit këndonin të përmalluar. Tutje përtej gardhit dëgjuam hapat e lehtë, që gërvishnin errësirën. Pastaj ja behu midis varreve hija e gjatë. U sul hija midis varreve drejt qiriut të ndezur. Erdhi e u kërrus, zgjati krahun të rrëmbente kanistrën dhe ne të dy kërcyem e ja rrokëm fort krahun Vllasit. Ai dha pallmën nga goja e nga poshtë.

Ne i futëm nja dy grushta të mira që mos t'i binte të fikët nga frika. Gjyshi doli nga stalla duke shkrofëtitur e duke mallëkuar veten, Vllasin dhe shenjtorët me soj e sorollop. . .



## SHKUESIT E KUADROVE

Shpirti i repartit i kishte bërë llogaritë mirë. Fundja ndërmarrjen e shtetit mendonte të forconte. Se mos po interesohej për mallin e babait!

Repartit i montimit donte inxhinier mbi kokë, Organikë kishin, po inxhinier jo. Sa herë ishte ngritur problemi:

— Nuk shkojnë punët mirë në repartin e montimit!

— Nuk shkojnë dhe s'kanë për të shkuar kurrë, po s'na dhanë një inxhinier të zot. Pikë!

— Të kërkojmë me këmbëngulje!

— Kërkoni!

Dhe drejtori urdhëroi shefin e kuadrit:

— Kërko!

Por ndërmarrja, ashtu siç nuk ka vetëm një repart, ashtu nuk ka edhe vetëm një problem. Nisi të mos shkonte mirë edhe repartit i lustrimit.

— Ç'ndodhi me lustrimin, që ka shkuar gjithmonë mirë? — u nxeh drejtori.

I thanë:

— Inxhinierja e repartit, shoqja Feride, lindi fëmijën e dytë. Leja e lindjes është e gjatë dhe...

— Por ajo dje sikur lindi të parin, more vëllezër! Ç'është kështu?

— Kështu siç e ka zënë ajo, — tha një tjetër — duket që përveç, repartit të montimit, do të na e sjellë mendjen vërdallë më keq edhe reparti i Feridesë!

— Po, po, ashtu është. Mëse e drejtë.

— Po ç'halli, o shokë?

E menduan hollë e gjatë dhe mendimi nxori propozimin.

— «Ta martojmë»!

Këtë fjalë të shefit të kuadrit nuk e kuptuan të gjithë. Drejtorit i qeshi buza.

— Mirë thotë, «ta martojmë»! Zaten, neve na kanë kërkuar.

Pas kësaj plasi gazi.

— «Ta martojmë»! — thanë.

Dhe ju ngarkua shefit të kuadrit ta ujdiste këtë martesë.

Dhe me të shkuar në zyrën e tij, nxori letër e karbon. i futi në makinë të shkrimit dhe nisi:

«Karakteristikë»

për inxhinieren, shoqen Feride Lulja:

Qëndrimi moralo-politik:

..... shembullor!

Ngritja ideo-profesionale:

..... e mrekullueshme!

Aktivizimi:

... si në detyrat shtetërore, edhe në ato shoqërore — i shkëlqyer!

Vetitë:

...vë interesin e përgjithshëm mbi gjithshka, dallohet për shpirtin e vetëmohimit dhe të sakrificës, është revolucionare, e disiplinuar, me vullnet të he

kurt, e thjeshtë, inteligjente, e sjellshme dhe e dashur në shoqëri. . . Gjatë qëndrimit në ndërmarrjen tonë ka bërë dy racionalizime. . .»

Dhe shefi e qëndisi, drejtori i firmoi, shefi tjetër e vulosi karakteristikën e shoqes Feride dhe ia nisën atyre që me kohë kërkonin një kuadër të zotin për ta ngritur në përgjegjësi.

Kaluan disa javë. Shoqja Feride ende nuk kish-te mbaruar lejen e paslindjes, megjithatë dëgjoi për «thashethemen» që po qarkullonte në ndërmarrjen e saj, se dikush paskësh thënë «të interesohemi e ta martojmë shoqen Feride».

Ajo u çudit për këtë shaka pa kripë dhe shkoi një ditë e ju ankua kryetarit të komitetit profesional të ndërmarrjes.

— Përkundrazi, — i tha kryetari — ne kemi respektin më të madh për ty. Në daç të dish, po ta them në konfidencë, por mos i thuaj hë për hë njeriu, kam marrë vesh se së shpejti ngrihesh në përgjegjësi.

Dhe shoqja Feride iku e qetë në shtëpi për të kryer lejen.

Të nesërmen e thirrën në Komitetin e Partisë. I thanë:

— Kemi një kërkesë nga ndërmarrja juaj për një inxhinier për repartin e montimit. A nuk jeni në gjendje ta kryeni ju një detyrë të tillë?

Ferideja nuk po kuptonte.

Tha:

— Unë kam repartin e lustrimit, jo të montimit.

— E dimë. Po sikur të kaloni në atë të montimit, meqenëse ndërmarrja juaj është keq me atë repart?

— Me gjithë qejf, — tha Ferideja — por mua

nuk ma ka shtruar njeri një gjë të tillë. Ku të ketë nevojë ndërmarrja, jam gati.

— Domethënë mund ta kryeni punën edhe në repartin e montimit?

— Më së miri.

— Ju falemnderit. Na falni, shoqja inxhinierë.

— S'ka përse!

Ferideja shkoi në shtëpi në fillim pak e habitur, pastaj i ra ndër mend fjala e kryetarit të komitetit profesional dhe çoi buzën në gaz. Pastaj përsëri u habit dhe pyeti veten: «Kjo qenka ngritja në përgjegjësi? E pse s'ma tha drejtori që do të kaloja nga ky repart në atë tjetrin, por Komiteti i Partisë?»

Ndërsa Ferideja vriste mendjen për këto pyetje, Komiteti i Partisë ndërhyri pranë ndërmarrjes së saj që atë kuadër ta mbanin, meqenëse plotësonte të gjitha kërkesat (sipas karakteristikave të dërguara) për në vendin që kishin kërkuar kuadër jashtë ndërmarrjes dhe s'ishte nevoja të bëheshin lëvizje të kota, hyrje e dalje inxhinierësh në atë ndërmarrje.

Ç'gjë e papritur për shpirtin e repartit!

Drejtori ishte bërë tym. Ju shkreh shefit të kuadrit!

— More vëlla, ç'na bëre kështu? Na ngeci seleksionimi!

Dhe vardha, ku të dhemb e ku të djeg, o kurrizi i shefit.

Shefi i bërë për ujë të ftohtë, në kulmin e dëshpërimit thirri:

— Unë gjoja për mirë! Mendova se reklama është shpirti i tregëtisë. Pastaj ju vetë e firmosët dhe e vulosët reklamën... Ç'faj paskam unë, se malli s'u shit?

— Ore, po ti nuk na the ta shisnim, por ta mar-  
tonim!

Shefi tha:

— E po ju e kuptuat atëhere metaforën, tani  
pse më bini më qafë? Për këtë punë njëlloj është,  
si ta thuash ta shesim, si të thuash ta martojmë  
apo ta shporrim. . .

Drejtori u bë xhind:

— Shef! — bërtiti. — Mos u mundo të bësh  
dredha, po gjeja ilaçin kësaj pune!

Shefi hapi krahët dhe një buzëqeshje e lehtë  
ju përpëliti nëpër buzë. Tha:

— Unë ilaçin ja kam gjetur, por ju s'po më li-  
ni të marr veten. Më vutë përpara.

— Hajde, hajde folë! — s'i durohej drejtorit  
duke tundur dorën nervoz.

— Të kthejmë pllakën! — tha shefi i kuadrit.

Drejtorit i mbeti dora e ngrirë në ajër për një  
cast. Dhe menjëherë e përplasi në tavolinë:

— Të lumtë! I vetmi je, s'e ke shokun. . .

Shpirti i repartit që në një mendje me drejto-  
rin.

Dhe shefi shkoi në zyrën e tij, nxori letër e kar-  
bon, i futi në makinën e shkrimit dhe nisi:

«Karakteristikë

për inxhinieren, shoqen Feride Lulja:

Qëndrimi moralo-politik:

..... lë mjaft për të dëshiruar

Ngritja ideo-profesionale:

..... shumë e dobët.

Aktivizimi :

..... mjaft e plogët.

Të metat:

... e prirur për interesin vetiak, indiferente, e padisiplinuar, pa vullnet, mendjemadhe, grindavece, inatqare, nevrike, pjell fëmijë çdo muaj. . .»

Dhe shefi e nxiu, drejtori e shgrapsi, shefi tjetër e damkosi karakteristikën e shoqes Feride dhe ja nisën atyre që ndërhyjnë për ta mbajtur këtë kuadër, meqënëse ajo nuk mund të plotësonte asnjë nga kërkesat për vendin ku kishin kërkuar kuadër jashtë ndërmarrjes.

Inxhinierja mbaroi lejen e barrës dhe u paraqit të fillonte nga puna.

Një ditë prej ditësh drejtorin sikur e vrau pak ndërgjegjja. I tha shefit të kuadrit:

— Sikur e kemi shkelur pak e i kemi hyrë në hak asaj inxhinieres sonë të repartit të lustrimit.

— Nuk vjen e keqja nga kjo punë, — tha shefi — kur seleksionojmë, fundja ndërmarrjen e shtetit forcojmë, se mos bëme gjë për shpirtin e babait!

Por drejtori për çudi nuk po ngushëllohej nga këto fjalë ngushëlluese. Ai tha:

— Do ta marrë në analizë byroja e organizatës këtë mesele. . .

Në guaskën e tij shpirti i repartit i kishte pasë bërë llogaritë gabim!

## KOPSHTI YNË

Më i humburi ka qenë vërtet ky fshati ynë, por sot ka ndërruar si nata me ditën, prandaj ja kemi ndërruar edhe emrin. Nuk quhet më Xhahilaj, por Përparim. E çfarë Përparimi se! Gati-gati s'e mbajmë mend më as ne vetë. Dhe mburremi të gjithë me Përparimin tonë, që po fillon të hahet me qytetin. Mirëpo na ka gjetur belaja me kalamajtë. Ata po na pengojnë të ecim përpara. E, e, posi. Kalamajtë. Na plaçin sytë, po. Po na nxijnë faqen kalamajtë. Na i thyen e na i hodhën jashtë nga dhomat karriget.

— Duam të rrimë shesh në shtëpi, s'duam karrige! — thonë.

Pas karrigeve na prishën e na shkatërruan krevatet.

— Duam të flemë në shesh, s'duam krevate! — thonë.

Gjithsecili kujtonte se u ka shkrepur kështu vetëm kalamajve në shtëpi të vet. Kur ç'të dëgjonim! Ngelëm pa mend në kokë. Kalamajtë shtëpi më shtëpi në tërë fshatin kishin bërë sulm kundër karrigeve e krevateve.

— Na, more lanetër, prisni, ç'bëni kështu? Karriget e krevatet janë përparim në fshatin tonë Përparim. Dhe juve ç'ju gjeti e ç'ju hipi në kokë t'i shkatërroni?

— Duam të rrimë shesh!

— Duam të flemë përtokë...

Nga na dolën këta kalamaj të prapambetur, o vëllezër? Hej, pikë e zezë! Hej ç'na gjeti!

Sapo nisëm të hetonim çështjen e të zbulonim shkaqet, kalamajtë vërshyen nëpër fshat secili me puro në gojë.

— More, ç'i keni këto? Kush jua dha këtë duhan? Kush ju mësoi t'i bëni puro fletët e duhanit?

Kalamajtë kapardiseshin e s'na flisnin me gojë. Dridhnin a s'dridhnin rrotullame me fletët e duhanit, që i ngjisnin me pështymë e i bënin krejt si puro Havane.

U bë problem i madh në fshatin tonë Përparim. Kalamajtë po na çakërdiseshin e ne s'dinim t'i jepnim ujë viçes, se nga na vinte kjo e keqe. Mblidhu njëri me tjetrin, shoshit e poroshosh, kthe e sorollat, por fillin s'ja gjenim dot kësaj belaje që na zuri.

Në kulmin e çalltisjeve tona për t'i bërë zap kalamajtë, atyre u hyri zekthi e u tërbuan fare. Morën kërnallën. Nuk ja merr mendja kujt e s'ka njëri të besojë, por e vërteta që është një, o shokë, kalamajtë e fshatit tonë ju lëshuan lëndinave e kodrinave, kërcë e vrapo e kush e kush më fort, pëllisnin të gjithë si viçat. Në mbremje ktheheshin tufë-tufë dhe yrrja, pëllisnin sa kishin në kokë. Shpërndaeshin nëpër shtëpitë edhe po atë avaz: pëllit njëri, pëllit tjetri.

U bërtisnim:



— Plasja ju preu! Ç'keni kështu?

Ata pëllisnin.

— More, pushoni!

Ata veç pëllisnin.

— More, uluni e hani!

Ata me krye në çanak vazhdonin të pëllisnin.

— More, flini!

Mezi i koste gjumi dhe neve na binin veshët rehat nga të pëlliturat e kalamajve — viça

Na zuri lemeria. Thamë se ishte lodër e një dite, por kalamajtë tanë ishin bërë memecë. Si me ne, si me njëri-tjetrin merreshin vesh vetëm me të pëllitura. Nuk flisnin në gjuhën e njerëzve por të viçave.

E. kjo nuk durohej më...

Ngarkuam një komision në fshat të hetonte e të merrte masa që të shpëtonin kalamajtë nga kjo hata e zezë.

Puna e parë që bëri komisioni, vajti drejt e në kopshtin e fëmijëve. Kur ç'të shihnin? Një zallahi e madhe, një betejë e tmerrshme, një lemeri... Të njëzet e dy kalamajtë e kopshtit po kacafyteshin e po gjakoseshin. Vlonin shkelmat e grushtat. Çirreshin me thonj e lëshonin piskama të thekshme. Ishin bërë piramidë në mes të dhomës njëri mbi tjetrin. Këmbë e koka, duar e prapanica lëmsh!

Ata të komisionit vunë duart në kokë edhe dhënë ca britma alarmi. Kalamajtë u ngritën. U shpërndanë anëve të dhomës! Të sakatosur e të dërmuar rrinin kokëvarur.

— Ç'keni, ore, kështu? Pse ziheni?

Të gjithë sa ishin drejtuan gishtërinjtë tregues në mes të dhomës, aty ku kishin qenë grumbull duke u kacafytur.

Në mes të dhomës anëtarët e komisionit dalluan një kukull të shtrirë në dysheme, të cflitur më keq se kalamajtë.

Të gjithë me gishtërinjtë tregues tek kuklla e shtrirë qanin e thërrisnin:

— E dua unë, ë, ë. . .

— Do të loz unë, unë!

— E dua, e dua. . .

Një i komisionit thiri fort:

— Prisni, de, pushoni një herë, se na morët mendjen!

Kalamajtë pushuan së qari, por dhoma u mbush me të pallura viçash.

— More, ç'keni? Prapë filluat si viça ju?

Jo. Kalamajtë kokëvarur nuk po pëllisnin. Komisioni ngeli gojëhapur tek shikonin kalamajtë gojëmbyllur e megjithatë dhoma buçiste nga të pallurat e viçave. Kush ishin ata që pëllisnin? Viçat, viçat e vërtetë. Kopshti i fëmijve ishte brenda në stallën e lopëve, i ndarë me një fije kompensatoje.

Komisioni mezi i dha dum kësaj pune dhe nisi të mbante shënimet e çastit, por. . .

S'ishte thënë t'u shkonte puna mbarë. Njëri nga të komisionit u thye më dysh, u këput e u shuk për tokë. Një deng duhani kishte rrëshqitur nga trarët poshtë.

Ata të komisionit të tmerruar tërhoqën për këmbësh shokun e tyre, duke thirrur për ndihmë edukatorin e kopshtit që s'dihej se ku ishte. Nga të briturat e gjithë atyre burrave, edukatorja më së fundi dëgjoi atje jashtë, tutje gardhit, ku po shullëhej e po bënte çorape të leshta për dimër. Nuk vraponte dot e varfra, se çalonte me të dyja këmbët. Anëtarët e

komisionit nisën t'i kërcënoheshin, t'i bënin pyetje e t'i kërkonin llogari, por ajo e varfra ngëc-ngëc-ngëc donte një çerek ore të nxirrte një fjalë nga goja, se ishte belbacuke, thujse memece fare.

Kur e panë që po humbnin frymën kot, ata të komisionit ngarkuan në krahë shokun e alivanosur dhe u drejtuan në zyrën e kryetarit të Këshillit.

— Kryetar, kryetar! Dil të na japësh llogari! — thirën që jashtë ata.

— Prisni, se kemi mbledhje me rëndësi — tha kryetari nga dritarja.

— More, shiko ç'ka ndodhur në kopsht!

— E, e, — përgjegjej kryetari nga dritarja, — kemi një javë që mblidhemi ditë për ditë për punën e kopshtit.

— More, atje nuk shkohet...

— E dimë. Janë konceptet e prapanikëve që pengojnë.

— Ore, të themi se ai nuk është kopsht, po...

— Ne për kopsht e kemi raportuar. Punën tonë e kemi bërë.

— Edhe ne do të bëjmë tonën. Nuk i durojmë kalamajtë në stallë. Karrige s'ka, krevate s'ka, lodra s'ka...

— E ç'na ka gjetur ne që jemi rritur pa lodra, po lernani rehat. Kemi mbledhje këtu, s'kemi dava lodrash. Qenkeni më ngë ju.

— Kryetar, mos folë kështu!

— Për kopshtin e kemi fjalën përsëri? Qenkeni tuhaf ju! Ju thashë që kemi një javë që po vrasim mendjen për kopshtin.

Dhe komisioni atëhere u largua me shpresë se nga mbledhja që po vazhdonte një javë të tërë diçka

do të dilte dhe problemi i kopshtit dhe i kalamajve të fshatit do të zgjidhej më së miri.

Mirëpo dukej që mbledhja do të vazhdonte edhe disa javë të tjera, se kopshti mbeti si kopsht zoologjik. Ndërkaq ne prindërit një nga një nisëm të mos i çonim kalamajtë atje, së nuk donim as të na zhgërryeshin përtokë, as të na mësonin duhanin, as të na bëheshin viça.

Kur mbetën aqë fëmijë sa edukatore (domethënë një) komisioni mori mundimin edhe një herë të mësynte zyrën e kryetarit të këshillit.

— Kryetar, kryetar! Ende po e vrisni mendjen? Epo na thoni një herë pse po e vrisni kaq fort, kryetar? Për kopshtin gjë s'po bëni!

— Ja, për kopshtin e kemi, more vëllezër. Po caktojmë ditën kur ta mbyllim!

Komisioni u tromaks.

Njëri tha:

— O shokë, të lajmërojmë një orë e më parë për këtë xhahillëk që dashkan të bëkan këta.

— Shkoni, shkoni e lajmëroni, — tha kryetari buzagaz — detyrën tonë ne e kemi kryer. Kopshtin e hapëm. Për këtë kemi raportuar. Kemi dërguar listat e shifrat. Dhe jemi fare në rregull. Tjetër gjë s'kemi ç'bëjmë ne. Vetëm ta mbyllim!

## RËNKIMI

Megjithëse dukej sheshit që s'i kishte ardhur mirë, bile ishte pak i prekur në sedër e pak i tron-ditur, Miço Qebapi fshihej dhe rrëfehej si i gëzuar e i kënaqur.

— Ore, eja të të qeras me një gotë birrë të them, — i tha ai shokut të tij — se tani jam kaq rehat sa s'ta merr mendja.

Kokën e vogël përpjetë, barkun përpara, dorën e djathtë në xhepin e kostumit blu, Miçua i futi krahun e majtë shokut dhe u kthye në birrari.

Shoku bënte ç'bënte dhe niste përsëri nga e para:

— Mirë, o Miço, mirë, por ta kam llafin, që vetëm këtë të kishin menduar, se ti e krijove, ti e ngrite, ti e zgjerove NSHN-në. Kush nuk e di se drejtorëve që kanë qenë atje s'u kanë zënë këmbët dhë, se s'ja dilnin dot. Ti e mbajte atë. Trembëdhjetë vjet nëndrejtor ti dhe tani...

— Ore, pse bëhesh tuhaf! — ngulte këmbë Miçua si njeriu më i kënaqur i kësaj bote. — Nëndrejtor isha, nëndrejtor kam shkuar. Rrogën njëlloj. Të gjitha njëlloj. Telashe më pak. Kapelen në sy. Sikur ta kisha kërkuar me qiri, të them.

— Epo gëzuar, pra.

— Gëzuar e më tej! Se ka edhe një të mirë tjetër kjo mesele.

Miçua qeshi me supe e me bark edhe uli zërin:

— Me këtë rast kaloj edhe fruthin.

Dhe Miçua shpërtheu në gaz të shfrenuar. Shoku e shoqëroi.

Pastaj ai tha:

— Pa ty, Miço, do ta marrë lumi NSHN-në.

— Mos u bëj merak, — tha Miçua — një vit, dy, e shumta tre dhe shiko kur ta kthejnë Miçon përsëri në vend të vet. Nuk ma zënë vendin, të them.

— Nuk ta zënë, se s'ka kush e bën përveç teje.

Dalëngadalë, shko ditë e shko muaj, Miço Qebapi mundohej ta kthente përsëri në sy postin e nëndrejtorit të ndërmarrjes së furnizimit të punëtorëve, mirëpo për çudi nuk po i ecte. Se ç'kishte ndryshuar në këtë mes, Miçua s'e kuptonte dot. Kjo ndërmarrje donte t'ja hante shpirtin. Megjithatë Miçua ishte prerë për nëndrejtor dhe nuk bënte as kaq e as aqë më tepër se sa i takonte një nëndrejtor. Nuk ekzistonte ende ajo lloj punë që të mund t'i hante shpirtin Miço Qebapit. Sa gjëra nuk shkojnë mirë, euhaha, nëndrejtor është nëndrejtor dhe udhëheq. Kritika pse është? Ai s'e ka gojën vetëm për bukë. Një autokritikë sa për të qenë brenda dhe ec të ecim. Por doli se përsëri punët nuk shkojnë mirë, kuptohet se fajin nuk ka se si ta ketë nëndrejtor. Bjeri t'u biem të tjerëve dhe fërko veten. Dhe, duke ecur kështu, duke u munduar ta kthejë në sy, Miço Qebapit në krye të një viti e gjysmë i doli përsëri emri.

Ku?

— Nënkyetar kooperative bujqësore.

Atje ku ja dhanë këtë lajm, muret e dhomës nuk ishin të verdha. Megjithatë fytyra e Miços sepse u ngjye me reflekse të verdha. Atij për të parën herë në jetë i theri brinja e djathtë. Rënkoj, u për-cuall e tha:

— Ju ndoshta nuk e dini që unë kam ca arësye...

E megjithëse Miçua numëroi një zinxhir të gjatë arësyesh që s'e lejonin të hidhte çapet deri në fshat, e bindën që të shkonte. Dhe i thanë se kooperative ku po e çonin si nënkryetar ishte atje në rrëzë të qytetit.

U bë turist. Posi, posi. Turist i mirëfilltë.

— Ore, sikur ta kisha kërkuar me qiri, — u tha dy shokëve në atë berrarinë e tij të preferuar, — katër-pesë orë tevatyr nëpër fusha dhe pastaj yrysh Miçua këtu në berrari.

— Ka një çikë baltë dimrit. — tha njëri.

— Se mos e kam marrë me tapi unë! Ja, një vit, e shumta një e gjysmë, se një e gjysmë e bëra, dhe vendin në NSHN bosh e kam. Kthehem e s'më lot topi më si njeri i ardhur nga baza!

Dhe nisi Miçua përditë të trokiste në dyert e komitetit ekzekutiv. Dhe kthehej përditë në zyrë të kryetarit të kooperativës bujqësore për ta pyetur nëse kishte ardhur ndonjë lajm për të.

Pa dalë mirë dimri, kryetari ja dha atë lajmin që priste Miçua. Kishte ardhur një shkresë nga komiteti. Në shkresë thuhej se në qytet kishte përfunduar së ndërtuar fabrika e qumështit. «Për këtë, mendojmë që të caktohet nga kooperativa juaj një kuadër i zoti për drejtorinë e kësaj fabrike, i cili të ketë familjen në qytet».

Miçua u hodh dhe e puthi në të dyja faqet kryetarin. Kryetarit ju bë zemra mal nga këto dy të puthura, se deri atë ditë, ky Miçua, ja kishte prurë në majë të hundës.

Miçua tha:

— Kuadër me rëndësi për drejtorinë? Që të ketë pa tjetër familjen në qytet? Shkurt dora vetë, Miço Qebapi! Apo jo, kryetar?

— Më qartë s'ka ku të shkojë, — tha kryetari — të shkosh shëndoshë e të na falësh kusuret, shoku Miço, se helbete, edhe kemi bërë fjalë ndonjëherë.

— Ç'janë këto fjalë, o kryetar! Fundi, ne jemi grindur ndonjëherë, për hir të punës e kemi bërë.

— E, posi, — tha kryetari — është e ditur.

Dhe Miçua e puthi edhe dy herë të tjera dhe mori vrapin për në qytet.

— Nëndrejtor i NIQ-it, o vëllezër, u tha tri sho-keve Miçua, atje në birrarinë e preferuar — a e dini ç'do të thotë? Vend pëllumbash!

Mirëpo thonë se ç'bie sahati, s'e bie moti. Një vit të tërë Miçua nuk pësoi gjë. Hynte e dilte në zyrën e vet të nëndrejtorit dhe tundte peshqirin. E kritikonin si burokrat, e kritikonin për shkëputje nga masa, e kritikonin se po mykej. Miçua, si bulli me mizat, tundte bishtin. Një vit të tërë kështu, por në një mëngjez të kthjellët pranveror Miços i theri brinja e djathtë. E pra, as kishte djersitur, as ishte ftohur. Vetëm atje në karrige, kur lexoi shkresën e transferimit, i djersitën duart, ju drodhën dhe ja dhanë thikat në brinjë. Miçua rënkoj thellë. E emëronin shef në NTSHVAK. E ulnin në përgjegjësi. S'ishte shaka.



Dha e mori tërë natën me veten e tij, ku ta gjen-  
te kleçkën për të kundërshtuar. Dhe e gjeti.

Shkoi të ankohej.

— Kjo është padrejtësi. E kundërshtoj këtë vendim.

— Pse? — i thanë.

— Si, pse? Më ulen 23 lekë në pagën mujore Kundërshtoj kategorikisht, ju them. Padrejtësi!

I thanë se qëndrimi i tij ishte mirë t'i shtrohej kolektivit të ndërmarrjes ku punonte.

Miçua i prerë tha:

— Do ta kërkoj më lart!

E thirën të paraqitej në mbledhjen e kolektivit të NIQ-it. Por a mund të shkonte Miçua të ulej ac poshtë dhe të dëgjonte masën që të vendoste për punën e tij? Kjo ishte qesharake dhe ofenduese. Miçua e dinte rrugën. Jo atje poshtë, por shkoi e trokiti lart që të kërkonte t'i vihej autoriteti në vend. Pesëmbëdhjetë vjet në udhëheqje ai, tani merrej nëpër këmbë? Ku ishte parë e dëgjuar kjo?

I thanë të paraqitej në NSHN.

Miços i mbinë fletët. Fluturimthi shkoi e mblo-  
dhi shokët e tij të zemrës dhe ja shtroi në birrarinë e preferuar.

— Eee? — thërriste Miçua i dehur gjysmë nga gazi, gjysmë nga birra — A s'ju pata thënë se në krye të tre vjetëve Miçua kthehet në vendin e vet?

— Hajt, gëzuar, Miço Qebapi!

— Kam thënë unë, di ta vërtitësh ti, Mico...

— Pse, unë s'të pata thënë, o Miço, se pa ty NSHN-në e merr lumi?

— Hajt, gëzuar!

— Gëzuar e më tej, shokëni. Që sot e tutje le të qarkullojnë të gjithë me kuç e me maç, se Miço Qe-

bapi e kaloi fruthin për bukuri dhe tani s'e lot më as topi i nemces!

Dhe të nesërmen Miço Qebapi, me kokën e vogël përpjetë, barkun përpara, dorën e djathtë në xhepin e kostumit blu, u paraqit i krekosur në ndërmarrjen e tij të dashur për të zënë karrigen e vet të shtrenjtë, që po e priste gjithnjë bosh, me ankth dhe e dëshiruar.

U shemb rëndë-rëndë në atë karrigen e tij me jastëk të butë, aqë sa e bëri të kërciste fort. U mbështet me të dyja duart në tavolinën e tij të lustruar, por me një cipë pluhuri përsipër, psherëtiu dhe qetë-qetë nisi t'u tregonte kolegëve, që mbushën plotë zyrën, odisenë e tij trevjeçare plot peripeci e telashe. Rrëfeu heroizmat e tij nëpër postet nga shëtiti, se si kudo që shkoi i gjeti përtokë dhe i ngriti në këmbë, se si...

— Por ama, ore shokëni, edhe u kalita ca. Njeriu ka nevojë të freskohet, të ajroset! Veçse jo më shumë se tre vjet, jua them singërisht si vëllezër, se më shumë ka rrezik njeriu të plevitohet...

Në këto çaste solemne ja mbërriti edhe drejtori i NSHN-së, sekretari i organizatës bazë dhe shefi i kuadrit. U përshëndoshën me Miçon dhe i thanë thjesht se atë e kishin sjellë atje për të punuar në prodhim.

Miçua u ngurosoi në karrige.

— Si është e mundur, — belbëzoi — unë i barbartë midis atyre?

Rënkimi i thellë, që i doli nga thelbi i ndërgjegjes, e shoqëroi me shkundjen e mëngës së kostumit blu, që i ishte bërë pak me pluhur mbi tavolinë.

## BURRA DHE GRA

Ditë marsi. Fryn e shfryn veriu. Lumi midis tokave të kooperativës ka ngrirë kallkan.

Përtej lumit gratë e ngrohta dhe vajzat e nxehta të brigadës së pestë bëjnë qilizëm. Midis tyre vetëm dy burra. Ata mezi t'i zë syri, se kanë humbur midis fustaneve.

Në anën tjetër të lumit dy traktorë buçasin. I ngasin dy çupa, dy motra, faqekuqe posi molla. Janë në garë të dyja. Plugojnë tokat për mbjelljet e pranverës.

Dhe në mes, aty pranë lumit, përpara zyrave të kryesisë, një zjarr i madh bubulak. Njëzet burra rreth e rrotull ngrohen, qeshin e gajasen. Muhabeti për njëzet palë qeje!

Nga zyrat del Aliu vetullngrysur. Hyn në rreth të burrave pranë zjarrit. Nga rrethi çohet Saliu dhe shkon brenda.

— E, ç'të thanë? — e pyesin Aliun këta rreth zjarrit në oborr.

Atje brenda në mbledhjen e kryesisë pyesin Saliun:

— E Sali, po ti?

Saliu syvëngër thotë:

— Nuk punoj dot me shatë. Më gjeni një punë burrash. Me qerre ose karrocë.

Del Saliu e kthehet pranë zjarrit, midis burrave. Ngrihet Veliu dhe shkon brenda.

— E, ç'të thanë? — e pyesin Saliun atje pranë zjarrit.

Kurse brenda në mbledhjen e kryesisë:

— E, Veli, po ti? — i thonë.

Veliu trashalug e rrumbullak thotë:

— S'është për mua kazma. Dua një punë burrash. Me parmendë ose me mistri.

Del edhe Veliu e kthehet në oborr, midis burrave. Ngrihet Bahriu dhe shkon brenda.

— E, ç'të thanë? — e pyesin Veliun ata jashtë.

— Po ti, Bahri? — pyesin ata brenda.

Bahriu me mustaqet thotë:

— Me bel nuk punoj më. Çomëni në zdrukthtari ose rroje natë.

Del dhe Bahriu dhe hyn Vehbiu. Del Vehbiu dhe hyn Syriu... Dhe në fund fare i erdhi radha Ilmiut.

— Hë, Ilmi? — e pyesin ata të kryesisë.

— Vetëm punë grash, me kazmë e shatë e bel e ku ta dij unë, — thotë Ilmiu — nuk bëj. Ç'të doni ju tjetër, jam gati. Por zemra më qan për llogaritar.

Njëri nga të kryesisë thotë:

— Po ti, more Ilmi, nuk ke arësim përkatës!

Një tjetër thotë:

— Po ti, more Ilmi, nuk je marrë kurrë me punë llogarie!

Kryetari thotë:

— Ti, more Ilmi, tri herë brigadier, tri herë je shkarkuar si i paaftë. . .

Ilmiu kishte një damar jeshil dredha-dredha në tamthin e majtë. I kërcente shpesh ai damar Ilmiut. I kërcëu edhe tani dhe tha:

— E kush i del zot llogarisë këtu, përveç meje? Njëri nga të kryesisë tha:

— Jot motër!

— Po, — tha një tjetër — Xhija, jot motër, është edhe me shkollë, edhe e shkathët.

Kryetari tha:

— Atë kemi propozuar, posi.

Ilmiut i kërcëu më fort ai damari jeshil.

— Unë pranoj — tha — vetëm llogaritar. Asnjë punë tjetër.

— Po ti the se. . .

— Thashë, ç'thashë, është punë për mua, — u nxeh Ilmiu — tani po them se s'pranoj asnjë punë tjetër.

Me të dalë nga zyrat, Ilmiu nuk u ndal në oborr, në rrethin e burrave që ngroheshin pranë zjarrit.

— Na, more Ilmi! Ç'të thanë, ore? — e pyetën burrat rreth zjarrit.

— Hiç — tha Ilmiu dhe mori vrapin tutje, përtej lumit.

Gratë e ngrohta dhe vajzat e nxehta të brigadës së pestë, midis të cilave priste i ngulur në tokë edhe beli i Ilmiut, vazhdonin qilizmën. Djersa i rridhte ballit. Gazi u ndrinte ndër sytë.

Brigadierja, Lulja, i bëri zë:

— Tani dilet në punë, o Ilmi?

Ilmiu s'ju përgjegj fare. Bloi e lllomotiti me vete: «Ç'më çan kokën, bishtshkundësja e dreqit! Dje e

kisha nën urdhër, sot kërkon të më vërë frerin. Por s'ka ardhur ende ajo kohë, që t'u hipin gratë në shpinë burrave si Ilmi Bademi!» Pështyu tutje e thiri fort:

— Oj Xhije! Xhije moj!

E motra përtej ngriti kryet:

— Hajde, o Ilmi, se vajti dreka.

Ilmiu kishte ngulur këmbët në tokë e nuk shkullej. U hakërrua:

— Hajde ti këtu dhe jo të vij unë atje!

E motra u bind.

— Ç'ke kështu, o vëlla?

Ilmiu ja bëri me kokë të dilnin tutje, buzë sopit.

— Ç'ka ndodhur, o Ilmi?

Ilmiu hipi majë sopit si kaposhi majë plehut. Shfryu:

— Sakën se pranon të bëhesh llogaritare, se....

— Pse, o Ilmi?

— Se kështu them unë! Llogaritar do të hyj unë.

— Mirë, o vëlla, t'u bëftë motra. Ne ty të kemi si sytë e ballit!

— Ashtu, de, ik tani. Edhe kyçe! More vesh? Mora thuaaj!

— Mora — tha Xhija.

Kryesia tërë javën merрте e jepte me Xhijen për ta vënë llogaritare. Xhija nuk jepej. Ilmiu priste ku në shtëpi e ku në klub, t'i dorëzonin çelësat e llogarisë. Dhe kaq i sigurtë ishte se me sot e me nesër do t'ja dorëzonin ata çelësa, sa të gjithëve, kush e pyes-te, u përgjegjej që do të fillonte punën në llogari.

Një ditë e takoi një djalë që vinte nga qyteti.

— Jam gazetar, — i tha — desha të takoja me ndonjë nga të kryesisë. Ju, çfarë pune bëni ?

— Llogaritar — i tha Ilmiu hijerëndë.

— Sa mirë! — tha gazetari dhe hyri në muhabet. — Unë desha të shkruaja për emancipimin e grave, — tha ai — ju këndeje për shembull si i keni punët?

— O! Kaq mirë sa s'ka ku të vejë. — tha Ilmiu. — Jemi kooperativë e dalluar ne në emancipim. Për pjesëmarrjen e grave në punë këtu te ne as që bëhet fjalë. Ato bëjnë qilizëm, hapin toka të reja, bëjnë prashitjen, korrjen, vjeljen e të vonave. Ku ka punë për kazmë e për shatë, atje i gjen gratë!

— Sa mirë! Shumë mirë! — u kënaq gazetari dhe merrte shënim në blok.

— Ç'të të them tjetër! — mori zjarr Ilmiu. — Në qilizëm për shembull shumica e grave tona i realizojnë normat ditore 110-120 për qind. Ua kalojnë edhe burrave. Ca burra i realizojnë vetëm 80-90 për qind.

U habit gazetari dhe i ngriu lapsi mbi blok.

— Si është e mundur?

— E po, ja, e thamë që në fillim. Emancipimi!

— Domethënë, — tha gazetari — «burrat nënë hije, lozin kuvendojnë.»

Ilmiu qeshi. Ju duk tuhaf ky djalë, që fliste për hije në mes të dimrit.

— Jo, or ti shok, — tha — e para e punës, tani jemi në dimër dhe s'ja ka qejfi ndokujt të rrijë në hije. E dyta, burrat te ne bëjnë punë burrash. Po edhe lozin e kuvendojnë, posi. Nga të paskemi ty, o byrazer?

— «Nga lumi që të më marrë!» — tha gazetari duke tundur kokën i thelluar në shënimet, me të cilat mbushte fletën e blokut. Dhe pastaj pyeti:

— Si e keni emrin ju, llogaritari i kooperativës?  
Ilmiut i dogji.

— E di ç'ke ti, — tha — mua ende nuk më kanë vënë llogaritar, jam në pritje, prandaj më mirë çap vetë e bisedo me ata të kryesisë. Ja ku i ke zyrrat. Ato atje. Hajt me të mira. . .

— Dale, po ç'punë bën ti tani, o shok?

— Nuk di gjë unë — tha Ilmiu dhe i grahu këmbëve.

Të nesërmen mori vesh, se ata të kryesisë kishin marrë në llogari një nuse me shkollë e të shkathët si Xhija. Ilmiut i kërceu damari jeshil. Dhe u hakmorr keq. Vendosi të mos dilte fare në asnjë punë. E shoqja punonte. Qejf, o qerrata! Burri — burrë, nuk e fut qafën në kularin e asaj bishtshkundëses, brigadiere. As kazmë, shatë e bel nuk zë me dorë. Po të donin për llogaritar, atje e kishin Ilmiun, le ta kërkonin.

Pas disa ditësh një gazetë po shkonte e po vinte fort dorë më dorë nëpër kooperativë. I erdhi edhe Ilmiut.

I kishte dalë emri edhe atij midis të mykurve me mendime mikroborgjeze e me koncepte patriarkale, të cilëve ai gazetari u dërgonte këtë përshëndetje: «Pika që s'u bie, se nga gratë rrojnë!»

U bënë gazi i kooperativës.

Ilmiut i kërceu më fort se kurrë ai damari jeshil, por, kur pa të tjerët që hoqën dorë nga kërkesat për punë «burrash» dhe dolën në arë me kazma, shata e bela, damari dalëngadalë nisi t'i ulej e t'i tulatej dhe më së fundi, kur mbeti fill i vetëm, s'pati nga t'ja mbante, uli kurrizin dhe u bë «grua».



## KARKALECI NË DHALLË

Që me raportin e parë nuk më ngrohu ai djalë. Fund e krye nxinte raporti. Gjatë dy javëve të kontrollit poshtë në bazë dukej se ishte tërfatur për të fryrë të metat. Dukej se gjithshka e kishte parë me gjyzlykë të zez. Asgjë pozitive, asnjë fill drite në punën, përpjekjet e gjithë atyre njerëzve të sektorit tonë në qytetin ku ai ushtroi kontrollin. Dhe në konkluzionet raporti nuk honepsej fare. Gjykime subjektive dhe herë-herë pesimiste. Mendjemadhësi me brirë! Firmosur raporti: Mak Sula. Edhe emrin e vet e kishte transformuar ky djalë. Kulmi! Natyrisht, nuk mund t'i kishte hije emri i demoduar Maksut Sula!

T'ju them të drejtën, që kur e prunë nga bangot e shkollës drejt e këtu, nuk ma pati qejfi. Posa e pashë, nuk e diç se pse m'u kujtua ai që tregojnë se i hante tmerrësisht patatet, por, kur e pyetën se çfarë ishin patatet, u përgjegj: «Me siguri duhet të jenë drunj të mëdhenj që bëjnë kokrra dimër-verë». Nejse. Pasi lexova raportin e tij, e thirra:

— Kaq përtokë qenkan atje, shoku Maksut? — i thashë.

Ai u ngrehos e gufmoi si gjel deti. Tha:

— Ç'pyet. . .

— Po më habitni, — i thashë — ne kemi edhe kuadro me eksperiencë atje. Si është e mundur të kenë rënë kaq poshtë ?

Ai nxirrte tymin e cigares fjolla-fjolla i kapardisur këmbë përmbi këmbë. Më përfshiu me një vështrim të pjerrët e tha:

— Ja që hë!

Ndërhyra:

— Po ndonjë diçka pozitive, që përbën tendencën e zhvillimit, ndonjë formë, ndonjë metodë, ndonjë gjë që mund të përfitojmë edhe ne, nuk vutë re fare?

Buzëqeshi i mallëngjyer e tha:

— Të thëna të bukura këto, por. . . le të mos futemi në këtë temë akademike. Fakti është se nuk ka asgjë. . .

— Po ju ç'bëtë? A i ndihmuat ndopak? — i thashë.

— E ç'ndihmë mund t'i japësh rutinës. Rutina nuk shpartallohet!

Isha plotësisht i qartë. S'kisha pse ta zgjasja më. Me këtë djalë duhet punuar shumë, përndryshe mund të ketë rrezik që ndonjë ditë të kërkojë të vjelë patate nga eukaliptet.

Vendosa të shkoja bashkë me të në kontrollat poshtë. Pas disa ditësh, dy javë para vitit të ri, u nisëm në jugë.

E lashë ta udhëhiqte ai kontrollin. Unë vëzhgoja. Që në hapat e parë na vuri në pozita të vështira. Kapadai, me hanxhar në dorë, priste më të katër anët. S'la njeri të hapte gojë.

Kur shkuam në hotel atë natë, e kritikova rëndë. Nuk bindej. U detyrova ta urdhëroja që nesër e tujtje, deri në fund, kontrollin do ta udhëhiqja unë.

— Bën mirë të mësosh — i thashë — nga këta njerëz punëtorë, të zotë e me eksperiencë.

E udhëhoqa unë kontrollin. Por ai vazhdoi avazin. Kërcente e ndërhynte vend e pa vend. Me shpirt ndër dhëmbë ja dola në fund kontrollit. Mblodhën punonjësit e sektorit për konkluzionet dhe detyrat. Na e trazoi mbledhjen. Nuk mund të merrte fjalën njeri, se vërsulej Maksuti dhe i çarçavosi të gjithë.

— Gabim! Kryekëput gabim! — ja këpuste njerit!

— Jo, s'është ashtu — ndërpriste tjetrin.

— Mos na fut në qorrsokak — i bërtiste tjetrit.

U bë i padurueshëm. Hajt ta përmbaje.

Ja punoi një punëtor. Kur e ndërpreu për të tretën herë, punëtori ju zbraz:

— Ore shok, mjaft të dëgjuam ty. Mos kërce si karkaleci në dhallë!

Plasi një gaz që e mbërtheu në karrige Maksutin. Të shtatë ngjyrat e ylberit ja ciklosën fytyrën njëra pas tjetrës. Në fund erdhi e t'u nxi sterrë. Por nuk guxoi më të kërcejë.

Ishte inatçi i madh si një fëmijë i llastuar. Gjysmën e rrugës në tren nuk foli fare. Hahej e brehej me veten. E ngacmova:

— Kur të vë përpara masa...

Shpërtheu:

— E kam mëse të qartë se ju i luftoni të rinjtë! Konservatorizmi nuk ka brirë...

Shfreu mirë e mirë. Unë e lashë. Pastaj urtë e butë i them:

— Dëgjo, more djalë. Të gjitha sa the, t'i fal. Ti e merr derën më krahë. Veç një gjë nuk të fal. Si është e mundur që edhe gjatë këtij kontrolli nuk të hyri gjë në sy?

Qeshi me ironi nga lart poshtë.

— Mësimi më i vogël ka vlerën e vet — i thashë. — Nuk më harrohet ajo fjala e atij punëtorit për karkalecin në dhallë. Shkulesh gazit, po të kesh rastin të shohësh kur bie ndonjë karkalec në dhallë. Ke parë ndonjëherë?

— Nuk merrem me gjëra boshe — tha.

— Do të mundohem të ta tregoj njëherë se si kërcen karkaleci në dhallë — i thashë duke qeshur.

Dhe vërtet ja përgatita eksperimentin. Mora një tas me dhallë dhe lëshova brenda një karkalec të vërtetë. Maksuti çakërriste sytë. Me siguri mendonte se sa naiv e kishte shefin e vet. Mirëpo për pak sekonda, ashtu siç plasi gazi në atë mbledhjen, kur ai punëtori i tha Maksutit të mos kërcente si karkaleci në dhallë, na plasi gazi edhe ne të dyve, mua e Maksutit, kur pamë karkalecin të përpëlitej e të rrihte krahët në dhallë. Merrte hov karkaleci e kërcente përpjetë dhe përsëri binte në tasin me dhallë. Kërcente përsëri e binte, përpëlitej, mbledhte forcat e prapë hidhej. Kërcente e s'kërcente karkaleci kryeneç e ne të dy qeshnim me lot.

Kështu vazhdoi derisa ju njomën mirë krahët në dhallë, u lodh e u nde mbi sipërfaqe i raskapitur.

Vuri mend e s'kërceu më.

Kush? Maksuti?

## DY SHTATZENAT

Nusja — barkun deri në buzë. Dhija e bardhë — barkun gjer në tokë. Dy shtatzënat në shtëpinë e Bakush Strallës pritëshin të lindnin o në një kohë, o njëra pas tjetrës. Kështu kishte thënë plaka, e shoqja e Bakushit. Dhe ashtu duhej të ishte.

Nusja — kokën varur e sytë përdhé. Dhija e bardhë — kokën lart e sytë xixë. Nuses i kishte dhënë kooperativa lejen e barrës. Dhisë ja kishin dhënë Bakushi me të shoqen. Kur vinte në mbrëmje nga puna Ganiu, mezi priste të shoqen në dhomën e fjetjes deri vonë. për ta pyetur se si e ndjente veten, e për t'ju gëzuar së bashku fëmijës së parë që po prisnin. Por e shoqja vonohej e vonohej, se punët e shtëpisë nuk kishin të sosur.

Kur vinte në dhomë, nusja s'kishte frymë më të gëzohej. Ngordhte në gjumë. Trembej natën.

— Moj ti, ç'ke kështu? — e përmendte i merakosur Ganiu.

— Vdiqa. Nuk e di ç'kam — ankohej e qahej nusja.

Vendosi Ganiu ta vizitonte te mjeku.

— Ku thé? — i bërtiti të birit Bakush Stralla.

— Ç'është kjo mendje, o bir? Nuk ke turp të turpërohesh? — ju gërmush e ëma. — Mos u përziej në punët e grave ti!

— Po është sëmure! — guxoi e tha Ganiu.

— Ik, shiko punët e tua ti, atë bëj! — urdhëroi Bakushi.

Plaka ju zhgreh nuses:

— Po ti, moj faqezezë, me sa mend i ankohesh burrit, moj? Shtrëngo, moj, barkun mos të të duket! Pika nuses! Si nuk hapet dheu të të përpijë, moj korbë... Derisa të pjellësh, nuk ke për të fjetur më me burrin! Dëgjove? Të marrtë mortja, të marrtë! Qysh nuk ke turp, moj faqenxirë...

Ganiu vështroi cepin e mustaqes që i dridhej të atit nga inati, dëgjoi dhe kërcënimet e së ëmës dhe s'pati nga t'ja mbante. Iku kokulur pa bërë zë.

— Na, more ti, — i thirri i ati, — mos harro t'i biesh dhisë një thes me gjethe të njoma, se nuk është mirë dhija, nuk i hahet.

Nusja po qante pa zë në dhomë të fjetjes.

— Moj, po ç'u bëre? — ulëriu plaka.

— Erdha, erdha, nëne... Ja, po rregulloja pak dhomën.

— Po vajti dreka, moj e shastisur! Shtrati i dhisë pa pastruar, ujë s'ke mbushur, shtëpia pa fshirë, velenxat u kalbën në gotatë, preshtë për t'u prashitur... Tundu, moj kryqethyer! Qyqja — qyqja, ç'na ka gjetur me këtë hutaqe!

— Ja, nëne, ja...

Bakushi nga jashtë turfulloi:

— Nuse, nxirrmë bukën në rreze të diellit!

— Ja, baba, ja...

Plaka nga brenda çirrej:

— Hajde, moj, ngrei dyshekët e bëj jukun, moj shuge!

— Ja, nëne, ja...

Nuses i iku ngjyra e fytyrës.

Bakushi kërcënonte jashtë:

— Nuse, moj, e thave dhinë për ujë, që u thafsh!  
Po është barsë, moj! Duhet mbajtur në pëllëmbë të dorës, moj!

— Ja, baba, ja...

Nusja u bë fildish.

Plaku hante në rreze të diellit. Plaka hante brenda. Dhija hante buzë gardhit. Nuses i ngjiti gjuha pas qiellzës.

— Nuse! — bërtiste Bakushi jashtë.

— Nuse! — thërriste plaka brenda.

— Ja, baba! Ja, nëne, ja...

Mori nusja krodhet e plakut e të plakës dhe fshiu sahanët e tyre, sa zuri pak rrëzën e stomakut, të mos i binte të fikët.

Shko ditë e ikë javë.

Fundosej nga trupi nusja. Ligej. Fundosej nga mendimi. Me të shoqin nuk flinte më. Kujt t'i qahej? Ishte turp të qahej. Kokën varur ajo e sytë përdhé.

— Ja, nëne, ja...

— Ja, baba, ja...

Vjehri bërtiste mënjanë.

Vjehra çirrej matanë.

Palé, nisi edhe dhija e bardhë, me kokën lart, sytë xixa e qimen vaj, të tundte mjekrën e të thërriste si vjehri e vjehra.

— Nuse, dhija!

- Ja, baba, ja. . .
- Dhija, moj nuse!
- Ja, nëne, ja. . .

Fundosej nga trupi nusja. Ligej. Fundosej nga mendimi. Në shtëpinë e Strallëve më mirë të ishe dhi e bardhë. . . Po nusja është nuse e s'bëhet dhi. Nusezeza. Dhibardha.

Një ditë Ganiu s'po e njihte më të shoqen. Ju duk shumë e gjatë e shumë e hollë si një thupër e argjendtë. Kur po e vërente me vëmendje, ajo lëshoi një rënkim të thellë dhe i ra kazani i ujit nga duart e vetë u përmbys përtokë.

Dha e mori plaka t'ja shkëpuste nga duart të birrit.

— Ik ti, mos u përzihej në punët e grave!

Por Ganiu e ngriti të shoqen dhe e çoi brenda në dhomë të gjumit. Nusja erdhi në vete.

— Po shkoj të thërres maminë — i tha ai.

— Jo, — tha ajo — nuk kam gjë.

Dhe i ndritën sytë nga gëzimi që mbeti një herë vetëm me të shoqin.

— Jam mirë — i tha.

— Ti je keq, — tha Ganiu — dhe fajin e kam unë.

Ganiu dukej fort i zemëruar:

— Derisa të lindësh, s'do të kapësh punë me dorë. Do t'i them mamisë të vijë të të shohë. Do të flesh këtu në dhomën tënde. Për të ngrënë, do të të sjell unë.

— Po babai. . . nëna? — pyeti nusja.

— Kështu si them unë! — tha Ganiu.

Të nesërmen u sëmurën të dy pleqtë.



Ganiu u vinte përçark si amvisë e si infermier nuses, babait, nënës. Edhe dhisë.

— Nuse, eja më fërko shpatullat, moj nuse, se mbarova! — rënkonte Bakushi.

— Nuse, më shtyp këmbët, se vdiqa! — qahej plaka.

Një herë Ganiut ju shkrep të bënte shaka e ju përgjegj:

— Ja, baba, prit pak, se vjen dhija e të fërkon shpatullat!

— Ja, nëne, prit pak, se vjen dhija të të shtypë këmbët.

## NOVACIONI I ÇYRIT

Nuk besoj të ketë njeri që të mos njohë ndonjë nga ata tipa që i ngjajnë Shyqyri Taphavanit. Edhe në qoftë se ndokush nuk ka parë, do të ketë dëgjuar, por edhe po nuk pat dëgjuar, me siguri duhet të ketë ngrënë ndonjë tip të tillë. Prandaj edhe nuk po mundohem t'jua përshkruaj këtë Shyqyri Taphavanin, që shkurtimisht i thërresin Çyr Tapa.

I kërkohej Çyrit të bënte një mbledhje apo konferencë të zgjeruar të novatorëve dhe racionalizatorëve të ndërmarrjes së tij të madhe, shumëdegëshe. Vetëm t'ju gënjej, se s'e mbaj mend nëse kjo mbledhje apo konferencë u bë në prak të festës tradicionale të novatorëve dhe racionalizatorëve apo në një kohë tjetër. Por Çyri, megjithëse ishte nga ata që nuk kanë kurrë gjë në torbë, kishte një të mirë tjetër, që s'e bënte qejfin qeder dhe me gjakftohtësinë më të madhe, në çastet më kritike, ishte i zoti të të ngopte me lugë zbratur dhe të të çonte në çesme e të të kthen-te me etje të shuar pa pirë fare ujë.

— Mbledhje? Konferencë me novatorët dhe racionalizatorët tanë? Të të gjitha degëve, sektorëve dhe reparteve të ndërmarrjes sonë? Si urdhëroni. Që sot po deshët e bëjmë — tha Çyri.

— Sot jo, por sot një javë. Të organizohet mirë. Vjen edhe një i deleguar nga këshilli qendror i bashkimeve profesionale.

— Mirë se të vijë, — tha Çyri — gati jemi.

Dhe që të nesërmen Çyri shkoi në shtypshkronjën lokale dhe porositi 250 ftesa. Formatin, faqosjen dhe tekstin e ftesave e kishte qarë. Nguli këmbë që t'i shtypnin bukur. Dhe suksezi, mendoi ai, është i siguar. Kushdo që do ta merrte në dorë ftesën, do të mbetej pa mend. Bile edhe po të mos kishte menduar kurrë ndonjëherë për racionalizime, do të frymëzohej dhe me siguri matematike do të shpikte diçka.

Pas dy ditëve ftesat i erdhën në zyrë. Çyri mori në dorë një të njërin dhe e pa me vëmendje.

— Ju lumshin duart! Të mrekullueshme! — i tha atij të shtypshkronjës që ja solli.

Kur lexoi edhe citatin që kishte zgjedhur për faqen e dytë të ftesës, Çyri u frymëzua vetë i pari. Mori stilografin në dorë dhe u vu të mbushte emrat nëpër pikat e radhitura pas fjalës shokut. . .

Pasi mbushi pesëmbëdhjetë copët e para me emrat e udhëheqjes së ndërmarrjes, ngeci. Kroi një herë kokën, pastaj mbushi edhe një për vete. Piu një cingare. Cingarja i solli ndër mend të mbushte disa të tjera me emrat e përgjegjësve të degëve, sektorëve dhe reparteve të ndërmarrjes, por meqenëse nuk i mbante mend të gjithë me emra, vendosi që t'i dërgonte çdo dege, sektori dhe reparti me zarfe. Nxori një deng me zarfa. Secilës i futi nga shtatë deri më dhjetë ftesa. Pasi mbaroi edhe këtë punë, cingarja e dytë i solli ndër mend novatorët dhe racionalizatorët e ndërmarrjes. Deshte të hapte dollapët, sirtarët

e dosjet ku kalbeshin propozimet për racionalizime të punonjësve dhe të mbushte ftesa me emrat e tyre. Por nuk mori mundimin t'i hynte këtij telashi. Cingarja e tretë i solli frymëzimin. Nxori një deng tjetër me zarfa dhe shkroi mbi to përsëri emrat e degëve, reparteve e sektorëve të ndërmarrjes dhe poshtë ndër kllapa vuri shënimin «për novatorët dhe racionalizatorët së bashku me gratë e farefisin». Kjo ishte një ide gjeniale për të mbushur sallën plot e përplot.

Tërë ditën Çyri mbushi zarfa. Pas kësaj nisi ta hante meraku për sallën. Ajo e këndit të kuq të ndërmarrjes, duke parë stivat e zarfave të mbushur, ishte fare e papërshtatshme. Të deleguarit duhej patjetër t'i mbushej syri nga salla, një, nga pjesëmarrësit e shumtë, dy, dhe nga referati, tre.

Pjesëmarrësit u siguruan. Dyqind e pesëdhjetë veta s'i thonë shaka, por i thonë një e tetëmjta e popullsisë së gjithë Shqipërisë. Për referatin që do të mbante, nuk bëhej shumë merak. Çdo vit, në praktikë të festës tradicionale të novatorëve dhe racionalizatorëve gazetat shkruanin kryeartikuj dhe artikuj të shumtë. Koleksionet i kishte të lidhura për bukuri biblioteka. Këtu Çyri ju afrua edhe idesë për të siguruar një sallë speciale. Rroku dorezën e telefonit, krijoi numërin.

— Shtëpia e Kulturës? Jam Shyqyri Taphavani... Çyri, Çyr Tapa...

Kështu e siguroi sallën e madhe të konferencave të Shtëpisë së Kulturës. Pastaj i hyri edhe një herë nga e para ftesave për të shënuar vendin e ri të mbledhjes. Kjo që puna më e zorshme, se nuk ishte kollaj t'i nxirrje ftesat edhe një herë nga zarfat e t'i futje

përsëri. Pasi ja dorëzoi korrjerit t'i shpërndante, Çyrit i mbeti vetëm referati për të kopjuar.

Dhe dita e shënuar nëpër ftesat erdhi. Erdhi edhe i deleguari nga Tirana, të cilin e shoqëronte kryetarja e këshillit të bashkimeve profesionale të rrethit dhe vetë Shyqyri Taphavani.

Erdhi dita, por erdhi edhe ora.

Ishin mbledhur vetëm dhjetë-pesëmbëdhjetë veta.

— Kemi një si syfet të keq ne në qytetin tonë, — i tha Çyri të deleguarit, — për të ardhur vijnë, por gjithmonë me një gjysmë ore vonesë.

Dhe e futi të deleguarin në bufenë e Shtëpisë së Kulturës. E la ta mbante me muhabet kryetarja e b.p. të rrethit dhe vetë doli te shkallët e ndërtesës. Rrallë e tek e ndjente veten ngushtë Çyri, por ja që edhe ky ishte një nga ato rastet e rralla. Megjithatë ai përsëri s'e humbi toruan dhe s'e bëri qejfin qeder. *E thamë që e kishte këtë të mirë.*

— Ti shoqe, ç'bën këtu? — pyeti një grua që rrinte në këmbë prapa tij.

— Jam punëtoare e Shtëpisë së Kulturës — tha ajo.

— E di ç'të bësh? Dil një herë qark e vërdallë dhe këdo që të gjesh rrugës e dyqaneve, thirru të vijnë shpejt këtu. «Në Shtëpinë e Kulturës, thuaju, kanë hapur televizorin dhe po shohin ndeshje ndërkombëtare futbolli.»

Ndërsa punëtorja po habitej e s'po kuptonte ç'ishte ky muhabet kështu, një grup njerëzish bëri ballë tutje dhe po drejtohej për në Shtëpinë e Kulturës.

— Po ata ç'janë? — pyeti Çyri përsëri punëtoren.

— Janë ata të mbledhjes, — tha ajo.

— Të cilës mbledhje, moj? Pse s'i njoh unë punonjësit e ndërmarrjes sime? S'janë tanët ata!

Punëtorja tha:

— S'janë tuajët, por janë tanët.

— Aaa! Këtu të dua! — ju hap syri Çyrit. — Përse vijnë ata?

— Bëhet një diskutim krijues për romanin «Kur qesh tërë qyteti». Ja ku e ke shpalljen mbi kokë, lexoje.

Çyri u kthye dhe vërtiti kryet mbi shpalljen e shkruar me ngjyra. Kërkoi me sy orën kur fillonte diskutimi. Bukur, Tamam një gjysmë ore pas konferencës së tij. Mrekulli fare!

— Në ç'sallë e kanë mbledhjen? — pyeti.

— Në të voglën, lart — tha punëtorja.

Grupi i njerëzve arriti dhe po ngjiste shkallët e jashtme.

Çyri u doli përpara.

— Këtu në sallën poshtë, shokë e shoqe!

Pas tyre ja arriti një grumbull tjetër. Çyri përpara u priste rrugën.

— Këtu në sallën poshtë, shokë.

— Këtu në sallën poshtë, shoqe!

— Këtu, këtu, ju lutem. . .

Salla e Çyrit po mbushej për bukuri.

Çyri pyeti punëtoren:

— Si i thonë atij romanit, moj ti, shoqe?

— «Kur qesh tërë qyteti», — tha ajo — është libër për të qeshur.

Çyri, i gëzuar se po i mbushej salla, qeshi e i tha punëtore:

— Epo dihet, për të qeshur vinë mileti, kurse për

punët e mia që nuk janë për të qeshur, t'u vësh vinçat, nuk shkulen të vijnë. Kënde, kënde shok-o, këtu poshtë bëhet mbledhja — i thiri Çyri njerit që u drejtua për lart.

Ai shoku ndaloi i habitur. I tha punëtores:

— Po pse, moj Dize, ne u morëm vesh me drejtorin për sallën lart. Apo është e zënë ajo?

— Me leje? — ndërhyri Çyri. — Më falni. Cili jeni ju, se kisha kohë që po ju prisja.

Ai shoku u habit më tepër.

— E si po më prisnit, kur nuk më njihni?

— Më falni — tha Çyri — ju me siguri jeni ai që organizoni atë mbledhjen për të qeshur. Gëzohem. Prezantohem. Shyqyri Taphvani, shkurtimisht shoku Çyr...

Ai shoku ja plasi gazit. Tha:

— Ne nuk bëjmë mbledhje për të qeshur, por do të diskutojmë romanin «Kur qesh tërë qyteti». Unë kam referatin kryesor.

— Epë aty të dua — tha Çyri dhe nisi të fërkonte duart. — Prezantohemi: Jemi të dy, si unë, si ti, referuesit, por shiko si është ngatërruar puna, vëlla i dashur...

Dhe Çyri i shpjegoi hallin, i kërkoi ndihmë, nisi edhe t'i mbushte mendjen.

— Fundi i fundit për të qeshur mbledhen përsëri ata të tutë, po për mua e për të deleguarin që po pret në bufe, nuk mbledhen më. Pastaj, ty nuk të është bërë havale ndonjë i deleguar. Kupton, vëllaçko? Shokun ndihmoje në ditë të zezë, pa në ditë të bardhë s'ka nevojë njeri për ndihmë. Dhe mos u mërzit, se ta shpërblen vëllai ty, kur të gjendesh edhe ti keq si unë sot. Aman, vëllaçko, kërkohet ç'të

duash nga unë, vetëm më shpëto nga kjo ditë e zezë. . . Ore, po ty s'të bëhet dhe aqë vonë. Ne mbarojmë punë për një orë. Pastaj vazhdoni punën tuaj ju. Puna është sa të heqim qafe atë të deleguarin me kryetaren tonë të bashkimeve profesionale të rrethit. T'i kënaq unë me referatin tim dhe hajt, udhë e mbarë. . .

Ai shoku u mahnit e u trullas, aqë sa s'po kuptonte në ishte në ëndërr apo zgjuar. Por Çyri nuk kishte kohë të priste atë shokun sa ta sqaronte këtë gjendje e të vinte në vete. I futi krahun dhe bashkë me të u futën në bufe. Ftoi të deleguarin.

— Fillojmë? Punonjësit po presin.

Çyri futi të deleguarin bashkë me kryetaren përpara dhe i nisi për në presidium. Pas tyre u drejtua vetë me atë shokun që do të bënte më vonë mbledhjen për të qeshur, të cilin s'e lëshonte nga krahu. Dhe u ulën të katër në presidium.

Kryetarja hapi konferencën e ja dha fjalën Shyqyri Taphavanit për të mbajtur referatin.

Çyri, përpara se të ngrihej, ju lut edhe një herë atij shokut në vesh:

— Mos u mërzit, se ja, mbarova unë. Dhe hap sytë, se mos na bëjnë ndonjë proçkë këta në sallë.

Dhe doli të lexonte referatin. U kollit dhe filloi.

«Shoqe dhe shokë,

Novatorët dhe racionalizatorët që janë mbledhur në këtë sallë sot valavitin lart flamurët e fitoreve të tyre tekniko-shkencore. . . Ata kanë përburzur frikën dhe drojtjen, nuk kanë përfillur lodhjen, sepse puna krijuese kërkon punë vetëmohuese dhe kapërcimin e çdo vështirësie që del përpara. . .»

Nga kjo hyrje e çuditshme njerëzit në sallë u



bënë kureshtarë dhe po dëgjonin me vëmendje. Kurse atë shokun e tyre në presidium s'po e mbante karrigja. Një fytyrë i vinte, një fytyrë i shkonte. Fuste e nxirrte dorën në xhep ku kishte referatin për romanin «Kur qesh tërë qyteti» dhe s'dinte ç'të bënte. Çyri atje në podium lexonte shpejt dhe gjente rast t'i hidhte nga një vështrim qetësues atij të referatit tjetër. Mirëpo kjo gjendje zgjati deri atje ku mbaronte pjesa e parë e hyrjes së gjatë të referatit të Çyrit. Çështje e vërteta, referati i Çyrit nga fillimi deri në fund hyrje ishte, por aty-këtu, ai kishte futur disa pyka me shembuj konkretë nga racionalizimet e punonjësve të ndërmarrjeve të qytetit.

«Një furrë e re hoffman dhe një linjë e repërtulla të lehta me bira. . .»

Salla u trazua. Zallahia nisi me gumëzhitje dhe po zhvillohej me të qeshura e romuze.

Çyri provoi të vazhdonte:

«Inisiativa e NISH tullës. . .»

Midis sallës sikur u hodh një bombë me të qeshura të kondensuara që shpërtheu fort.

— Pushoni! — thirri njëri që po qeshte vetë me lot. — Romani i NISH Tullës qënka më humoristik. E paska titullin «Kur qesh e tërë salla»!

Askush s'po merrte vesh gjë dhe përveç Çyrit askush nuk e vuri re atë shokun e referatit të romanit humoristik në xhep, që ju afrua të deleguarit dhe diçka i pëshpëriti në vesh. I deleguari në fillim dëgjoj i ngrysur, pastaj ja plasi gazit dhe u bashkua me korin e madh të të qeshurave të sallës. Qeshte ende me lot, kur u ngrit në këmbë e thirri:

— Shokë! Shoqe!

U bë menjëherë qetësi.

— Nuk është çudi... Mundet që autori i romanit «Kur qesh tërë qyteti» të ketë pasur parasysh si prototip të gjallë për personazhin e tij Çuç Byrzerin, shokun tonë këtu, Çuç... më falni Çyr Tapën, që...

Në sallë shpërthyen bomba të tjera me të qeshura të zjarra.

## KUR QAJNË E QESHIN LOPËT

Po nuk besuat, që edhe lopët qajnë e qeshin si njerëzit, pyetni Rrapush Sulçen, stallierin e stallës së parë të fermës Nr. 3, dhe do të bindeni. As unë nuk besoja, si ju, prandaj shkova vetë te Rrapushi.

— Ec e m'i trego një herë, o Rrapush, ato lopët e tua që qajnë e qeshin si njerëzit — i thashë me të tallur.

— Ke hak ti, o vëlla. Jo ti që s'merresh me lopë, por edhe unë që rri ditë-natë me to, tallesha me zooteknikun, kur më thoshte se duhet treguar kujdes i madh për psikologjinë e lopëve!

— Psikologji? Lopët — psikologji? — çakërita sytë unë.

— Prit, o ti, shok, — tha Rrapushi. — mos u habit. Unë u bëra xhind me zooteknikun tonë. Thashë se tallej me mua dhe ju pata shkrehur fshaçe: «Ore shoku zooteknik, ty të ruat e ta mbash me shëndet atë shkollën e madhe që ke bërë, por mua s'ma hedh dot!» Dhe, që ta kam llafin, s'i lashë gjë pa thënë. Ai i varfëri më kërkoi njëqind herë të falur, po ku përmbahesha unë! Mirëpo dëgjo të të tregoj se si e pësova!

— Nga kush? — e pyeta unë Rrapushin.

— Nga lopët. Më zuri haka e zooteknikut. Shikomë këtu!

Rrapushi ngriti teshat e trupit e më zbuloi barkun e kurrizin.

— Shikon? Desh më lanë të vdekur lopët.

Në bark e në kurriz të Rrapushit dukeshin shtatë-tetë plagë të mbyllura.

— Tre muaj në spital, vëllai yt! Kam shpëtuar për qime! — tha Rrapushi.

— S'po marr vesh fare — thashë unë.

— Epo, ja që hë de, edhe lopët paskëshin psikologjinë e tyre. Dëgjo e mos u çudit të kam rixha! Që ta kam llafin, më pat ardhur në majë të hundës me ato këshillat e urdhërat për lopët. Kështu e ashtu lopa, kështu e ashtu për lopën, kështu e ashtu prej lopës. . . U bë lopa si gruaja e babës! Yrrja për lopët — stalla me salltanet si shtëpijat tona. Yrrja, ndaj toka, veç, ec mbilli me foragjere. Yrrja, bëj silazh për dimër e ku ta di unë! Lëre e mos e nga, i bëmë lopët nazelesha e hundëpërpjeta, që s'i mbeti gjë tjetër, veç, me nder jush, të na përm. . . edhe në kokë! Më kishte ardhur në majë të hundës, kur, do ti, kusuret s'kishin të sosur. Zootekniku përsëri nuk mbetej i kënaqur. Epo ç'do tjetër, more vëlla? «S'jemi mirë me lopët!» i ngeli goja.» Edhe na nxori atë që të thashë. Psikologjinë. Dhe na doli, se unë qenkështa stallieri më i dobët, se nuk njihja psikologjinë e lopës. Kurse ato çupërlinat, që kishin stallat e tjera, qenkeshin më mirë me psikologjinë e lopës. U bëra tym. E ç'ishte kjo psikologjia e lopës? Na qenkështe lezeti i ushqimit, rehati në stallë, gjimnastika, hija ose dielli në verë apo në dimër e tjera e tjera,

dhe çudia e çudirave na qenkeshe edhe ajo që i hyn në sy dhe e ka qejf lopa dhe ajo që nuk i pëlqen dhe e merr inat! «Të gjitha këto, thoshte zootekniku duhet ditur mirë që të japë lopa sa më shumë qumësht, mish, pleh, e viç të shëndoshë.» Epo kjo s'ishte parë e dëgjuar! Si të thashë edhe në fillim, ju shkrehu zooteknikut fshaçe dhe e bëra për pesë pare. Mirëpo dëgjo se si e pësova, se! Ca më kishte ardhur në majë të hundës, ca ma bëri shpirtin derr zootekniku me atë psikologjinë dhe unë, që isha një herë nopran me lopët, u bëra dhjetë fish. Kur hyja në stallë, për nder, ore, se të gënjej, dridheshin lopët nga frika. Qëllonte që s'e hanin ushqimin. «Kurrë mos ju rëntë në bark, gjidi maskaresha!» u shfryja unë. S'bënin rehat natën. «Ujku ju preftë, sojsëze të dreqit!» i mallëkoja unë. Ama, u shkonte shtatë prej meje. Sytë xixa u bënin, kur më vështronin mua. Lot u rridhnin dhe, ja, kokët e tyre gjithë varë. Qanin, ore, për nder qanin. Kur vinte puna, Rrapushi hante dhe pinte kritikë në brigadë e në kryesi të kooperativës. Lopët e mia nuk realizonin planin e qumështit. Lopët e mia ishin më të dobëtat. Lopët e mia pillnin viç shtrembanikë. Lopët e mia bënin bajga më pak! «Ju zëntë haka ime, që u robëtova pas jush, moj edepsëze, moj nurzeza, moj të mallëkuara!» u hakërrohesha lopëve unë. Kurse atyre në brigadë e në kryesi u përgjigjesha: «Nuk kam faj unë, por ju, që po i tërboni lopët me gjithë të mirat!» E që ta kam llafin, rashë në hall me të dyja krahët. Keq me njerëzit e keq me lopët. Por me njerëzit bëja si bëja. Kur e shihja pisk, bëja edhe ndonjë autokritikë. Veç, lopëve s'u përulesha. Jo, që të më merrnin lopët nëpër këmbë, s'e bëja veten. E po llaf ishte ai i zootekni-

kut? Të bëhesha merak a u kishte lezet ushqimi lopëve! T'u fërkoja vithet e t'i përkëdhelja e të bëhesha i dashur me to! Mirëpo, si të thashë, e pësova keq e më keq. E gjeta nga s'e pandeha, si i thonë fjalës. Që ta kam llafin, një natë, s'mbaj mend përse, e nxora dufin që më vlonte përbrenda te njëra prej lopëve të stallës sime. I hyra me shqelma dhe e dërmova fare. Ajo u bë një grusht. Si e shkrehja mirë e mirë inatin, i rashë stallës mes për mes që të dilja nga dera tjetër. As pashë gjë, as mora vesh se si ndodhi, veç kur e gjeta veten midis brirëve të lopëve. Pesë a gjashtë përpara, tri a katër nga pas, m'u vërsulën e më çanë si mos më keq. Të mos kishin vrapuar ato të stallave të tjera të fermës kur dhashë pallmën, vëllai yt do të kishte shkuar si qeni në stallë nëpër këmbët e lopëve. Them i kot ne, inat gomari, por paskëshin qenë lopët, ore, tungjatjeta. . . Lëre, lëre! Më dridhet mishtë, kur e kujtoj atë natë. . .

I them unë me shaka:

— Duket atë natë e paske njohur mirë psikologjinë e lopëve, shoku Rrapush.

— Jo, — tha — as për njëqind vjet nuk do të isha bindur që lopa ka si njerëzit, ashtu si thotë zootekniku, simpati dhe antipati për gjërat që e rrethojnë. Tre muajt që u shtrova në spital, stallën time e mori njëra nga mjelëset. Ajo është e qeshur, e urtë, e dashur. Është dhe e bindur. Dhe gazit të urtësisë dhe dashurisë së vet i shtoi edhe këshillat e zooteknikut. Nisi të kujdesej për lopët me merak, që nga ushqimi e deri te gjimnastika. Do ti, që stalla mori flamurin dhe doli e para jo në fermë, por në gjithë kooperativën? Ç'të të them, o byrazer. Pesë fish qumësht, ore!

— Po tani, — i thashë — që je kthyer përsëri ti?

— Aaa, desha s'desha, u binda. Tani kam filluar, bile, të ndjek edhe teknikumin bujqësor — tha Rrapushi. — Tani, po deshe, eja të shikosh vetë me sytë e tu.

Hymë në stallë.

Lopët, posa panë stallierin e tyre të dashur, e pritën me të pallura gëzimi e hareje.

Lopët vërtet qeshnin.

## PASQYRA

E kishim tërhiq e mos e këput tregëtinë në qytetin tonë të vogël. Dhe për këtë ishim të gjithë në një mendje, që nga nxënësit e vegjël e deri tek shefi i tregëtisë. Gjysma e «thashethemeve» të qytetarëve nëpër kafenetë e birraritë ishin «thashetheme» për tregëtinë.

— Ne në radhë të parë s'kemi shitësa, mor vëlla! Më thuaj një që punon tamam si shërbëtor i popullit...

— Janulla, Qirjakulla, Stavrulla janë të shkëlqyera!

— Demiri, Sotiri, Fatmiri...

— Mirë. Po të tjerët, të lutem shumë?

— Nuk ka kontroll, prandaj.

— Po pse, a kontrollohen qindra dyqane në qytet?

— Ç'pyet, kur ke ende shitës pa shkollë!

— Shkollat në prak të shtëpisë i kanë.

— S'i thua dot një gjysmë fjale shitësit, se ke frikë mos të të nxjerrë me shqelma përjashta dyqanit. Epo ç'pret nga ai shitës?

— Po higjena? S'u hedh dot sytë disa shitësve, se të vijnë zorrët në fyt. Pa le lokalit!



— Kemi edhe lokale të papërshtatshme, xhanëm.  
— Disa të papërshtatshme, disa të papajisura.  
— Po pse, po orarin e harruat?  
— Lëre orarin, as privatët në kohën e Nuhut nuk i hapnin dyqanet sipas qejfit, si ndonjë nga këta tanët

— Po kur dërgon fëmijën për fruta e zorzava-te? Ja «zgjedh» shitësi të gjitha kalbësirat!

— Fëmijës, the? Mua, more, me një barrë mustaqe, m'u ka tartarosur: «Në daç merri, në daç lëri!»

— Kulmi është kur shkon ndonjëherë në ndonjë bufe dhe mbetesh me gisht në gojë, se përveç kulaçeve s'ka gjë tjetër.

— Aaa! Lëre, lëre! Furnizimi i dyqaneve shkon rroq më troq. Depot plot, kurse në ndonjë dyqan thyen kokën miu. Pse? Hajt e merre vesh të kam rixha. . .

— Po kur furnizohet ndonjëri në orarin e shitjes? Të bije gjaku në fund të këmbëve për tri orë, sa mbaron furnizimi. Pastaj. . .

— Pastaj të bie damllaja, se shitësja do të rregullojë mallin.

— Mirë, ore, mirë, po kësaj ç'i thoni ju? Të tri dyqanet e lagjes sonë kanë dy muaj e ca mbyllur. Pse, ore, të shkretën? Se kanë inventar!

— Opo lëri të gjitha, po ajo që s'hahet. . .

— Ehuha, sa gjëra nuk i hahen tregëtisë!

— Jo, e kam llafin te rezervimet për miqtë e të njohurit.

— Ç'pyet, o vëlla, duhet të hash një furrë bukë që të kesh energji të numërosh kusuret e qyfyret e tregëtisë!

Kur qëllonte të merrte pjesë në këto «thashethe-

me» edhe vetë shefi i tregëtisë, ai ngrinte duart përpjetë e thoshte:

— Ja, edhe kontrolli punëtor u mor me ne kaq kohë, por se mos na thanë ndonjë gjë të re. Të gjitha ç'na thanë, ne i dinim me vakt e me kohë!

— Oj, i ditkeni! Po atëhere ç'bëni?

— Nuk kam ç'të bëj, o shokë! Veç të futem vetë shitës, vetë furnitor, vetë mercolog, vetë drejtor e vetë shef!

— Duket, edhe jashtë kafeneve, shefi i singertë, e thoshte hapur këtë mendim. Dhe një ditë prej ditësh shefin e hoqën nga tregëtia dhe i ngarkuan detyrë tjetër.

Më vunë mua shef tregëtie.

Ua thashë që në fillim:

— Kam frikë se nuk do t'ja dal në krye.

— E bën ti, e bën, se je merakli. Tregëtia një njeri merakli do mbi krye.

Unë vërtet merakli isha. Apartamentin tim e kisha stisur e stolisur për bukuri, por sektori i tregëtisë nuk është një shtëpi me dy dhoma, një kuzhinë, sallon e banjo. Megjithatë unë u bëra shef i tregëtisë. Të gjithë qytetarët i drejtuan sytë nga unë.

— Të shohim ç'do na nxjerrë në dritë shefi i ri — pëshpërisnin nga të katër anët.

Nga poshtë e nga lart prisnin shumë nga unë. Kuptohet, edhe unë doja të dilja faqebardhë, por e kisha të qartë edhe vetë se, sikur ezhderha me shtatë palë krerë të bëhesha, pa ndihmën e mobilizimin e të gjithë punonjësve të sektorit, s'do të mund të qullosja asgjë.

I mblodha të gjithë dhe u fola me dorë në zemër. U thashë:

— O vëllezër e motra, nga të katër anët na kanë vënë në shënjestër, se nuk jemi në terezi. Si do të bëjmë ?

— Të vijmë në kandar. Rrugë tjetër s'ka — thanë disa .

— S'ka! — thanë të gjithë

Atëhere unë thashë:

— Ju vetë e keni në dorë. Gjithësecili e di se ku i pikon dyqani. Edhe unë do të përpiqem. Por edhe ju të më ndihmoni mua!

U hyra në zemër.

Bile u habita edhe unë vetë, edhe ime shoqe, edhe fëmijët e mi se sa fort po më donin punonjësit e sektorit tim të ri. Që të më lehtësonin nga çdo gjë dhe t'i kushtohesha vetëm të kulturuarit të tregëtisë së qytetit tonë, punonjësit e sektorit tim arritën deri atje, sa të më shkarkonin nga meraku i furnizimit të shtëpisë sime. Çdo gjë e re, e bukur, e kualitetit të parë në veshmbathje, metrazhe, orendi shtëpiake ushqime e deri te parfumeria dhe mishi, na i rezervonin dhe, ose na i sillnin drejt e në shtëpi, ose kur kalonte gruaja apo fëmijët, thërrisnin vetë shitësit e ua jepnin të paketuara bukur e me shije të hollë si për vetë shefin. Kështu që unë dhe familja ime lodheshim tani fare pak. Sa për të paguar lekët!

## ASHTU HYNË, ASHTU DOLËN

Sifi fizikant dhe Aqifi matematicien vendosën ta bënin punën prodhuese në një kantier ndërtimi.

Loni piktor dhe Ndoni kompozitor vendosën të shkonin në fshat për të bërë punën prodhuese.

Dhe Nakua, nëpunës i seksionit të tregëtisë, e Sakua, nëpunës i seksionit të industrisë zgjodhën edhe ata fshatin për punë prodhuese.

Kush trenit, kush autobuseve, u nisën nga Tirana në një mëngjez të bukur pranveror.

Rrugës.

Tema më interesante e bisedave të Sifit dhe Aqifit ishte forcimi i ndërgjegjes revolucionare, duke jetuar me masat, duke hyrë në gjirin e tyre dhe duke u shkrirë me to. Ata nuk kishin rrugë aq të gjatë. Shkonin diku në një kantier ndërtimi në Shqipërinë e Mesme. Megjithatë arritën ta diskutonin në thellësi këtë temë kaq të rëndësishme. Diskutimet nuk i mbushnin me fraza të gjata, sepse flisnin shkurt, qartë, gati si me formula.

Loni me Ndonin udhëtonin drejt Veriut. Në mallësi, ata përveç punës prodhuese, mendonin të gjenin edhe frymëzimin drejtpërsëdrejti në gurrën fresku-

ese popullore për veprat e tyre të mëvonshme. Ata ishin mjaft entuziastë, se veç kësaj do të edukoheshin dhe do të kaliteshin si revolucionarë.

Drejt Jugut shkonin Nakua e Sakua. Ata do të punonin në një kooperativë bujqësore fushore. Mendonin të shkundeshin pak nga praktika burokratike, të mësonin nga masat si nxënës të mirë e të vullnetshëm.

Në kantier.

Që ditët e para të punës në kantierin e ndërtimeve faqet e verdha e të squllura të Sifit dhe Aqifit morën një ngjyrë të pjekur dhe nisën të mos u tundeshin më si pelte.

Sifi mbante zhavor me karrocë dore. Aqifi punonte me lopatë. Vepra që ndërtohej ishte madhështore. Entuziazmi i punëtorëve rrëmbeu edhe dy shkencëtarët. Vraponte Sifi me të katra, fluturonte me gjithë karrocë. Shpejtohej Aqifi me lopatë që të mos ngelej pas punëtorëve të tjerë. U shkante djersa çurg në lug të kurrizit. Ju argasën duart dhe bulëzuan kallot. Punonin hakçe. Të pestën ditë arritën të bënin normën si punëtorë të vërtetë.

Habitej Sifi:

— Ore Aqif, po ku paskemi genë ne? M'është shtuar oreksi, ore! Edhe zhavor të më vësh përpara, e ha.

Aqifi i afronte krahun Sifit, mblidhte grushtin dhe i tregonte muskulin të ngritur si vezë pate.

— Shiko këtu. T'i biesh edhe me sëpatë, s'do t'ja dijë!

Në malësi.

Loni me Ndonin, ditën e parë ishin mahnitur nga natyra e virgjër, poetike, fantastike. Ditën e dy-

të ishin mobilizuar për të rregulluar një dhomë në kryesi të kooperativës për të fjetur. Ditën e tretë ishin pak si të pamundur ngaqë ishin ftohur, si duket prej ujit tepër të ftohtë të gurrës nëntëvjeçare dhe ndenjën tërë ditën shtrirë. Ditën e katërt zhvilluan një bisedë të gjatë në kryesi të kooperativës me kryetarin e sekretarin.

Kryetari u tha:

— Nuk e di se si mendoni ju, o shokë, por ne si kooperativë e re e posakrijuar kemi nevojë të madhe për punë organizative dhe do t'ju luteshim të na ndihmoni gjatë kësaj kohe që do të qëndroni këtu.

Edhe sekretari u tha:

— Po, besa, do t'jua dimë për nder të madh.

Loni me Ndonin ngritën nga pak supet secili për vete, por nuk u shkoi ndër mend të kundërshtojnin, se nuk ishte fort i keq ky propozim. Loni mendoi për vete: «Gjatë punës prodhuese ne do të njihnim edhe realitetin. Por, ja, për tri-katër ditë e njohëm». Edhe Ndoni, sikur ta dinte se ç'po mendonte Loni, mendoi për vete: «E njohëm. Ç'ka tjetër për të njohur?» Loni vazhdonte të mendonte për vete: «Unë i bëj nja shtatë pejsazhe, kur të kthehem». Edhe Ndoni mendonte: «Edhe unë nja katërmbëdhjetë këngë i bëj, po të gjej tekste».

Atëhere Loni tha:

— Si të dëshironi, o shokë!

— Ashtu qoftë! — tha dhe Ndoni.

Në kooperativën fushore:

Pas tri-katër ditësh pune në fushë Nakon e Sakon i rrëmbeu vendimi i brigadës ku punonin, për t'i hyrë eksperimentimit për rritjen e prodhi-

mit të misrit. Brigada e kishte zgjidhur problemin e parë, kapërcimin e tokave ku do të zbatohet eksperimenti. Ishte vendosur, pasi kishin dhënë të gjithë mendimin që misri të mbillej në tokë që përfaqësonin afërsisht mesataren e pjellorisë së tokave të njerit prej sektorëve të kooperativës.

Nakua e Sakua morën përsipër edhe ata veç të tjerëve që tu hynin studimeve agroteknike që nga problemi i sistemimit sipërfaqësor të ngastrave eksperimentale e deri te mënyra e plehimit dhe e ujitjes, e prashitjes dhe e korrjes. Sigurisht që hapat e parë në këtë drejtim ata do t'i hidhnin me ndihmën e agronomit.

U mbyllën të dy, ditë e natë, në studime të thella shkencore dhe në analiza e sinteza. Entuziazmi i tyre kishte arritur kulmin. Parashikonin, ashtu si edhe agronomi, që nga parcelat eksperimentale të arrihej të merrej 80-100 kv. misër për hektar.

Në kantier:

Sifi dhe Aqifi vazhdonin të kaliteshin fizikisht. Muskujt e tyre forcoheshin dita-ditës, aqë sa të dy shkencëtarët po e ndjenin veten si gjysmë atletë. Meqenëse në mensën e punëtorëve hanin shumë veta dhe ajri ishte pak si i papërshtatshëm për mushkëritë e shkencëtarëve dhe pjatat e lugët nuk ishin të kualitetit të parë... dhe... edhe për shumë arsye të tjera, Sifi dhe Aqifi hanin e pinin në një restorant. Për arsye se që të dy kishin nga një kushëri në qytet, nuk flinin në fjetoret e punëtorëve. Dhe për arsye se punëtorët nuk dinin as fizikë, as matematikë të lartë, ata me plot arsye s'kishin se ç'muhabete të bënin me punëtorët, prandaj edhe sektorin e punës e kishin rregulluar në mënyrë të ti-

llë, që, meqenëse tërë kohën e lirë rrinin të dy bashkë, edhe tërë kohën e punës ta kalonin së bashku pranë njëri-tjetrit.

Në malësi:

Puna organizuese e Lonit dhe e Ndonit, sipas komplimentave të kryetarit e sekretarit, ishte mjaft frutdhënëse. (Po, kur u jep të tjerëve dorën, të marrin krahun!) Dhe sekretari një ditë ju lut shokëve-artistë të mendonin diçka se si mund të ndihmonin në gjallërimin e jetës artistike e kulture të malësorëve.

U hodh e ja preu Loni:

— Më mirë mos na ngatërro ti, shoku sekretar. Ne kemi ardhur këndeje për t'u freskuar, se puna e artit na ka ardhur deri në fyt!

Në kooperativën fushore:

Edhe problemin «të plehërojmë bimën dhe jotokën» Nakua e Sakua e zbuluan pas shumë studimesh të imta. Dhe menjëherë kaluan në përcaktimin e sasisë dhe kohës së ujitjes. Mirëpo, sa e nënvleftësojnë këta fshatarët punën mendore! Jo vetëm që i ftonin andej e këndeje, por s'i lanë rehat në studimet e tyre, duke u kërkuar mendime për probleme të ndryshme të organizimit, si shefa të komitetit ekzekutiv që ishin!

Në kantier:

Fundi i muajit të punës prodhuese erdhi si pa u kuptuar. Sifi dhe Aqifi nuk dalloheshin nga atletët e vërtetë. Kur u ndanë me drejtorin e kantierit, shprehën habinë e tyre themelore për jetën e punëtorëve:

— Interesant, — thanë — ne një muaj punuam midis punëtorëve dhe u bëmë si atletë. Po punëtorët,



pse nuk i drejtojnë lutje komitetit të fiskulturës për t'u pranuar atletë profesionistë e të shpëtojnë nga puna e pakualifikuar e punëtorit?

Në malësi:

Atë ditë që Loni e Ndoni do të largoheshin nga malësia, meqë nuk dinin rrugën se nga duhej të shkonin dhe ç'shteg të merrnin për të dalë në xha-  
de, ju lutën kryetarit e sekretarit që t'i shoqëronin, se sigurisht qentë e fshatit nuk mund ta njihnin ekipin e punës organizative që kishte jetuar dhe punuar një muaj të tërë në zyrat e kooperativës.

Në kooperativën fushore:

Një natë para nisjes për Tiranë (domethënë, para daljes nga gjiri i masave) brigadieri i brigadës eksperimentale i ftoi e gati i mori me zor për darkë në shtëpinë e vet Nakon e Sakon si shenjë miqësie e falenderimi për kontributin e çmueshëm që dhanë me studimet e tyre në lëmin e agroteknikës gjatë muajit të punës prodhuese në kooperativë.

Krisën rakia e pulat e pjekura shqiptarçe.

Nakua e Sakua çakërcejf shpërthyen:

— More, po ku paskemi qenë ne derdimenët tërë muajin? Ç'na u desh agronomllëku neve?

Nakos ju kujtua zanati i vet dhe pyeti:

— Me sa i shet tregëtia juaj këtu pulat?

Brigadieri buzagaz tha:

— I rrisim vetë!

Po edhe Sakos ju kujtua zanati i vet dhe pyeti:

— Fabrikë apo punishte e keni ju këtu atë të pi-jeve?

— E ziejmë vetë, shoku shef!

.....  
Jo më kot thamë që në krye:

Hynë e dolën...

## NËPUNËSI I GRUMBULLIMIT

Pas pallateve të reja, në një cep ku dikur ka pasë qenë pazari i vjetër, gjendet pika e grumbullimit të vjetërsirave. Është një si dyqan gjysmë i anuar e i pashembur ende. Atje punon Shyqyri Ballkasa, që grumbullon, çmon dhe blen vjetërsira.

Shyqyriu vetë nuk është i vjetër. Posa ka mbushur të tridhjetë e shtatat. Meqë e vriste aqë lart saqë e mbante veten për më të zotin ndër gjithë të tjerët, për dy vjet rrjesht ndërroi afër dymbëdhjetë punë të ndryshme, tejsëtejmes i pakënaqur.

Flitej se është njeri pak si i çuditshëm. Disa thoshin se kulturën që ka ai, se ka askush në qytet. Disa qeshnin e thoshin se Shyqua është një biçim torollaku. Të tjerët thoshin se ai bën sikur është edhe ashtu, dhe kështu, me qëllim që t'ua hedhë të gjithëve. Pra, është një lloj pelivani, thoshin.

U bëra kureshtar dhe vendosa ta njihja vetë. Kisha një tabaka të vjetër në shtëpi. E mora një ditë dhe ja çova në dyqan. Dukej që s'ishte i vjetër, por flokët i kishin rënë krejt.

U entuziasmua. Posa i vura në tavolinë tabakanë, tha:

— Je i pari që më sjell një antikë! Dukesh menjëherë që s'je prej këndej. Nga të kemi?

Hyra në muhabet. Lëshonte një breshër sharje për qytetarët vendas, injorantë, pa kulturë, vulgarë, që çonin në pikën e grumbullimit të vjetërsirave vetëm pantallona të grisura, xhaketa dalëboje, këpucë shtrembanike, shishe parfumes të lyrosura etj. etj.

— Ku marrin vesh këtu se ç'janë antikitetet! Ja, më kënaqet shpirti. Kjo tabaka është e kohës së Abdyl Hamidit II.

Megjithëse e dija fare mirë nga gjyshja se tabakaja s'ishte aq e vjetër, u bëmë miq. M'u lut që të kaloja herë pas here andej.

— Se këtu, — u ankua Shyqyriu — nuk ke me kë shkëmben dy fjalë për të qenë, o byrazer.

Ika dhe rrugës qesha me veten time. Por ende s'dija si ta përcaktoja. Që ishte i çuditshëm, ishte.

E bëra fjalë me shokët. Më porositen që të mos gaboja ta thërrisja «Shyqo», sepse të mbante një orë për të shpjeguar kuptimin e emrit «Shyqyri», që turqit ua vinin vetëm atyre njerëzve, për të cilët bota do të bënte shyqyr që lindën për meritat e tyre të mëdha.

— Tani, — tha një tjetër — tërë qyteti i thërret Shyqyri Ballkazani, meqë e kemi yndyrën e shoqërisë sonë.

Qeshnin shokët e mi dhe çfarë nuk tregonin! Thoshin se dinte edhe frëngjisht. Disa thoshin që më tepër se nëntëdhjetë e nëntë fjalë frëngjisht nuk dinte dhe ato i përdorte vend e pavend. Tjetri ja priste:

— Ai mund të kënaqet vetëm po ta vinin rektor universiteti!

Unë bëhesha ende më kundërshtar. Të kishte vallë kulturë të gjerë?

«Flokët më kanë rënë nga studimet». Këto fjalë i ka në majë të gjuhës Shyqua.

Shkova dhe i bëra vizitën e dytë dhe nuk i thirra «Shyço». Nuk pata menduar as edhe një kurdisje si më patën porositur shokët, por ai kurdisej vetë në çast dhe, pa e zgjatur fort, nisi të zbraste kulturën e tij të gjerë.

— E kuptoj, — tha — që çuditëni se si kam kantandisur në një nëpunës të thjeshtë grumbullimi. Ta dëgjosh historinë time, do të vësh duart në kokë! Ja, vetëm një gjë të të them. Pse për shembull të mos më merrnin si shkencëtar në Universitet. Unë jam në gjendje të jap në çdo shkencë. More, në lëmin e fizikës, të kimisë e matematikës. Apo do në histori, letërsi?

Kur vështroi sytë e mi që po zmadhoheshin fort, tha:

— Mos u habit! Të marrim fizikën. Vetëm për akustikën unë të mbaj leksione të tëra. Vjen nga greqishtja *akouein*. Kemi nerv akustik, kemi aparat akustik që shërben për shurdhët. Akustika është pjesë e fizikës që studion tingujt... Të mos e zgjasim, se bie sikur dua të shes mend. Po le të marrim kiminë. Ç'është albumina për shembull? Është substancë organike e grupit të protideve. E bardha e vezës është albuminë që quhet ovalbuminë, albumina e gjakut quhet serum albuminë, e qumështit — laktalbuminë. Sa traktate do të shkruaj për albuminën? Sa të duash. Do matematikë? Algjebra! Nga rrjedh fjala algjebër? Nga arabishtja al xhabër. Algjebren u futën në Evropë arabët rreth vitit 950. Hidhemi në histori...

— Nuk ka nevojë — i thashë. — Unë jam i bindur se ju keni një kulturë shumë të gjerë.

Ju bë qejfi shumë.

— More vëlla, — tha — e kam mikrob, e kam sëmundje. Po nuk grumbullova kulturë, unë nuk mund të jetoj.

— Gjynah — thashë. — Sa mirë do të ishte që ta vinit në shërbim të shoqërisë gjithë këtë kulturë. Ç'fakultet keni mbaruar?

— Vazhdova nja tri, por i lashë përgjysmë. Nuk më pëlqenin. Nuk mësohet gjë e madhe nëpër fakultete.

— Jeni erudit.

— Po.

— Pse nuk keni kërkuar të hyni për shembull në arësim?

— S'më pëlqen. Të përplasim në ndonjë fshat.

— Po çfarë pune do të dëshironit?

— Të them të drejtën, vështirë të gjendet punë e përshtatshme për mua. . .

E mbajta gazin përbrenda.

Erdhën dy fshatarë në dyqan me një thes me vjetërsira. Ika.

Me shokët hapëm përsëri punën e Shyqos.

— Të foli për akustikë? — më pyeti njëri.

— Po — thashë i çuditur se nga e kishte gjetur ai. Shokët ja krisën gazit. Pyesnin:

— Po për albuminën?

— Po për algjebrenë e për emrin Aleksandër që është emri i tetë papëve?

— Po për Alpet, për apopleksinë, për autoklavat?

— Po për Abrahamin dhe perëndeshën japoneze Amaterasu?

Njëri u hodh e i ndërpreu të gjitha pyetjet e shokëve dhe më tha:

— Të duhen edhe nja dy-tri vizita, — tha —  
— dhe, kur të të shpjegojë se ç'është automati e kur  
të të flasë për Anakreonin, atëherë do t'i biesh në  
në erë se ç'është Shyqyri Ballkazani i qytetit tonë!

Vërtet kisha vënë re diçka. Të gjitha ato që më  
kishte shpjeguar Shyqua dhe të gjitha ato që pritej  
të më shpjegonte, siç thoshin shokët, çuditërisht fi-  
llonin me gërmën a! Megjithatë vajta përsëri.

Vërtet kësaj radhe më foli për tetë papët që ki-  
shin pasur emrin Aleksandër e për të gjithë me radhë.  
Pata durim dhe ai doli më në fund tek Anakreoni e  
tek automati.

— E di kush ka qenë Anakreoni?

Unë ngrita supet. Po e vështroja me vëmendje.  
E kishte kokën tullace me katër qoshe. Ai perëndoi  
sytë sikur të ishte shkruar në tavan ajo që do të tho-  
shte dhe filloi t'i nxirrte fjalët varg-varg. Ai fliste,  
kurse unë bëra lidhjen midis fjalëve që më kishte  
shpjeguar Shyqua dhe që fillonin të gjitha me a dhe  
kokës së tij me katër qoshe, që dukej tamam si një  
fjalor enciklopedik. Me siguri do të ketë ndonjë në  
shtëpi, mendova, dhe ende s'ka arritur te germa b.  
Kam njohur njerëz që grumbullojnë «kulturë të gje-  
rë» nga fletët e kalendarëve. . .

— Po automatin, e di ç'është?

Unë përsëri ngrita supet. Ai perëndoi përsëri  
sytë që të kujtonte shpjegimin e fjalorit enciklope-  
dik dhe tha:

— Automati është një lloj maqine që imiton lëvi-  
zjet e një trupi me shpirt. Por ka edhe kuptim figu-  
rativ. Automat i thonë atij njeriu që nuk mendon e  
nuk vepron me mendjen e vet. Sinonimi: marionetë.

— Mos e zgjat më, Shyqo-marioneta!

---

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

Faqe

Njollat .....	3
Historia e kandidatës .....	8
Zinxhiri i miqve të kooperuar .....	13
Qajnë arat për një burrë. ....	20
Saçi .....	23
Thëngjijt e mbuluar .....	29
As lulet nuk arritën të çelin .....	38
Mirë na e bëre, o Daut .....	45
Njeriu i padukshëm .....	51
Krahu i vllasit dhe shpata e shën Mëhillit .....	56
Shkesët e kuadrove .....	64
Kopshti ynë .....	70
Rënkimi .....	76
Burra dhe gra .....	82
Karkaleci në dhallë .....	88
Dy shtatzënat .....	92
Novacioni i Çyrit .....	97
Kur qajnë e qeshin lopët .....	106
Pasqyra .....	111
Ashtu hynë, ashtu dolën .....	115
Nëpunësi i grumbullimit .....	121